





Ku Qëndrojmë: Rishikimi i Progresit të Agjendës së Gjelbër në Kosovë

Kosovo Green Action



Qershor

2025

Përmbajtja

Autore
Sytrime Dervisholli – Hulumtuese

Shkurtesat	3
i. Përmbledhje Ekzekutive	4
1. Hyrje	5
2. Metodologjia	6
3. Përmbledhje e Agjendës së Gjelbër	7
4. Çështjet kyçe, Boshllëqet dhe Përmirësimet e Mundshme	9
4.1. Energjia	10
4.2. Klima	13
4.3. Transporti	15
4.4. Ekonomia qarkore	16
4.5. Përfshirja	18
4.6. Menaxhimi i mbeturinave	20
4.7. Menaxhimi i ujit	21
4.8. Sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zona rurale	24
4.9. Bujqësia	26
4.10. Biodiversiteti	27
5. Përfundimet	30
6. Referencat	31

Shkurtesat

ADA
BGF
BioNet
CBAM
DENA
BERZH

EE
EIB
ETS
BE
EGD
EIP
ENTSO-E

ZRRE
FAO

FOL
BPV
GET
GHG
GVA
Gwh
IUCN

ASK
KCSF
AMMK
FKEE
KGA
KOSTT

MCA
ME
MMPHI

MMTS
MRV
MW
NDC
PKEK
ODK
BRE
TC
OKB

Agjencia Austriake për Zhvillim
Balkan Green Foundation.
Rrjeti i Biodiversitetit
Mekanizmi i korigjimit të kufirit të karbonit
Agjencia Gjermane e Energjisë
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Eficienca energjetike
Banka Evropiane e Investimeve.
Sistemi i BE-së i Tregtimit të Emetimeve
Bashkimi Evropian
Marrëveshja e Gjelbër Evropiane
Plani Ekonomik dhe i Investimeve
Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energji Elektrike
Zyra e Rregullatorit të Energjisë
Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara
Lëvizja Fol
Bruto produkti vendor
Ekipi Ekonomik Gjerman
Gazrat serë
Vlera Bruto e Shtuar
Gigavat orë
Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
Agjencia e Statistikave të Kosovës.
Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës
Fondi i Kosovës për efikasitet të energjisë
Kosovo Green Action
Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit
Ministria e Ekonomisë
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Strategjia e Transportit Multimodal
Monitorim, raportim dhe verifikim
Megavat
Kontributet e Përcaktuara Kombëtarisht
Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë
Open Data Kosovo
Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme
Termocentral
Kombet e Bashkuara

Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport bazohet në vlerësimin fillestar të nevojave për të analizuar në mënyrë kritike progresin e Kosovës në zbatimin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Kosova ndodhet në një pikë kritike të tranzicionit të gjellbër. Ky raport identifikon zbrazëtirat sistematike, sfida institucionale dhe mundësi për përparim në fusha prioritare si tranzicioni energjetik, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i mbeturinave. Analiza synon të përmirësojë efektivitetin e Agjendës së Gjellbër si një kornizë strategjike për zhvillim të qëndrueshëm dhe përafrim mjedisor me objektivat e Bashkimit Evropian. Kosova ka bërë disa hapa përpara në hartimin e kornizës ligjore dhe strategjike, përfshirë miratimin e Strategjisë së Energjisë 2022–2031, Strategjisë për Ndryshimet Klimatike 2019–2028, Ligjit për Ndryshimet Klimatike (2024), si dhe draft Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK). Megjithatë, zbatimi pengohet nga joefikasitetet strukturore, burime të kufizuara financiare dhe koordinim i fragmentuar institucional. Përkundër përparimit modest në zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme, vendi mbetet shumë i varur nga linjiti, i cili paraqet një pengesë të madhe për dekarbonizim.

Gjetjet kryesore

- **Përparimi në Energjinë e Ripërtëritshme:** Kosova ka lansuar ankandin e parë për energji nga era (100 MW), duke shënuar një hap drejt një portofolio më të diversifikuar energjetike.
- **Angazhimet klimatike:** Vendi ka dorëzuar Kontributet e para kombëtare të përcaktuara (NDC), duke përshkruar objektivat për zbutje dhe përshtatje deri në vitin 2030.
- **Modernizimi i Transportit:** Me 38 milionë euro financim nga EIB, Kosova filloi rehabilitimin e 148 km të infrastrukturës kryesore hekurudhore rajonale¹.
- **Ekspozimi ndaj Mekanizmit të Korrigjimit të Kufirit të Karbonit (CBAM):** Edhe pse eksportet drejt BE-së përbëjnë vetëm rreth 1% të BPV-së, sektorët me intensitet të lartë të karbonit (çeliku, alumini, rryma) do të përballen me kosto gjithnjë e më të larta të lidhura me CBAM.
- **Financimi i gjellbër në faza të hershme:** Buxhetimi

i gjellbër dhe mekanizmat e financimit të gjellbër mbesin të pazhvilluara dhe ende nuk janë të integruara në mënyrë sistematike në planifikimin qeveritar.

- **Mbeturinat dhe Riciklimi:** Shkallet e riciklimit mbesin jashtëzakonisht të ulëta (2.5%), duke reflektuar zbatim të dobët dhe infrastrukturë të pamjaftueshme për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave².
- **Varfëria energjetike:** Mungesa e një përkufizimi ligjor për varfërinë energjetike pengon ofrimin e mbështetjes së targetuar për amvisëritë në nevojë.
- **Angazhimi publik:** Vetëdijesimi dhe pjesëmarrja nga shoqëria civile dhe sektori privat mbesin të kufizuara, duke dobësuar bazën për qeverisje gjithëpërfshirëse mjedisore.
- **Digjitalizimi i bujqësisë:** Programi për Bujqësi Digjitale, i mbështetur nga FAO, synon të nxisë inovacionin dhe qëndrueshmërinë në sektorin bujqësor.
- **Boshllëqet në rritje gjithëpërfshirëse:** Grupet e margjinalizuara – përfshirë fermerët e vegjël dhe gratë – nuk janë të integruar mjaftueshëm në iniciativat për qëndrueshmëri dhe sistemet e tregut³.
- **Biodiversiteti në rrezik:** Ekosistemet natyrore përballen me presion të shtuar nga zhvillimi dhe boshllëqet rregullative, duke kërkuar përpjekje më të fuqishme për konservim.

Prioritetet strategjike

Për të përshpejtuar tranzicionin e Kosovës drejt një ekonomie të gjellbër dhe të qëndrueshme, veprimet në vijim janë me rëndësi thelbësore:

- Zbatimi i ligjeve ekzistuese mjedisore me mbikëqyrje dhe llogaridhënie më të fuqishme.
- Krijimi i mekanizmave të dedikuar të financimit për infrastrukturë të gjellbër dhe energji të ripërtëritshme.
- Përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional dhe forcimi i kapaciteteve teknike.
- Mbështetje për partneritetet publiko-private që përputhen me objektivat e qëndrueshmërisë.
- Tërheqja e investimeve të përshtatura me klimën përmes krijimit të kushteve të parashikueshme dhe transparente të politikave.

1 Banka Evropiane e Investimeve. Burimi: <https://www.eib.org/en/press/all/2023-051-team-europe-eib-global-support-for-railway-network-modernisation-in-kosovo-reaches-eur80-million>

2 Koha.net. 2025. Burimi: <https://www.koha.net/en/arberi/ekspertet-e-mjedisit-kritikojne-institutionet-per-moskonsolidim-te-sistemit-per-rici-klim-te-mbeturinave>

3 Swisscontact. 2025. Burimi: Avancimi i sistemeve të tregut bujqësor në Kosovë

Ky raport shqyrton progresin e Kosovës në zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, me fokus në përafrimin e politikave kombëtare me standardet mjedisore të BE-së. Është hartuar në kuadër të Projektit Kosovo Green Action, i cili synon të përmirësojë qasjen në të dhëna mjedisore dhe energjetike përmes një platforme digjitale dhe të nxisë politikëbërje të bazuar në të dhëna.

Iniciativa, e udhëhequr nga Balkan Green Foundation në partneritet me Open Data Kosovo dhe Lëvizja FOL, angazhon institucionet publike, shoqërinë civile dhe sektorin privat në adresimin e pengesave strukturore për qëndrueshmëri. Përmes mekanizmave pjesëmarrës – veçanërisht Forumit të Gjelbër – projekti mbledh opinione dhe informata kritike mbi zbatimin e politikave dhe llogaridhënien.

Ndonëse Kosova ka hartuar korniza kyçe si Strategjia e Energjisë 2022–2031, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019–2028 dhe Ligji për Ndryshimet Klimatike (2024), zbatimi vazhdon të jetë i ngadalshëm për shkak të koordinimit të kufizuar institucional, zbatueshmërisë së dobët dhe kufizimeve financiare. PKEK është ende në pritje, ndërsa strategjitë për dekarbonizim dhe përshtatje klimatike janë në zhvillim.

Përafrimi rregullativ me standardet e BE-së në fushat e mbeturinave, cilësisë së ajrit dhe transportit është ende i pakompletuar. Strategjitë ekzistuese sinjalizojnë qëllimin e politikave, por u mungon mbështetja operative për të prodhuar ndikim. Ky raport ofron një analizë kritike të këtyre boshllëqeve dhe përshkruan rekomandime të zbatueshme për të mbështetur një tranzicion të gjelbër më koherent dhe të përgjegjshëm.

Ky raport aplikon një metodologji cilësore me fokus në politika, duke kombinuar analizën e dokumenteve me konsultime me akterë për të vlerësuar zbatimin e Agjendës së Gjelbër në Kosovë.

Hulumtim në zyre

Janë shqyrtuar strategjitë, ligjet dhe planet kryesore kombëtare për të vlerësuar përputhshmërinë me pesë shtyllat e Agjendës së Gjelbër dhe standardet mjedisore të BE-së. Këto përfshijnë Strategjinë e Energjisë 2022–2031, Ligjin për Ndryshimet Klimatike (2024), Strategjinë e Ujërave 2022–2030, si dhe strategjitë sektoriale në bujqësi, transport, mbeturina dhe biodiversitet.

Vlerësimi është përqendruar në koherencën, statusin e zbatimit, vendosjen e objektivave dhe përplotësinë rregullative.

Angazhimi i hisedarëve

Për të plotësuar shqyrtimin e politikave, janë mbajtur konsultime me përfaqësues të institucioneve shtetërore (p.sh. Ministria e Ekonomisë, AMMK, ZRRE), shoqërisë civile (EcoZ, Asociacioni i Komunave të Kosovës), sektorit privat (SunVolta Energy) dhe partnerëve zhvillimorë (Zyra e BE-së).

Në këto diskutime janë identifikuar zbrazëtitat institucionale, çështjet koordinuese dhe pengesat në zbatim, duke ofruar perspektiva kritike që nuk pasqyrohen në dokumentacion zyrtar.

Fokusi analitik

Gjetjet janë vlerësuar në katër dimensionet:

- Koherenca dhe gatishmëria e politikave
- Kapaciteti dhe koordinimi institucional
- Mekanizmat financiarë për zbatim
- Gjithëpërfshirja dhe angazhimi i akterëve

Përmbledhje e Agjendës së Gjelbër

3

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është në pajtim me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe përqendrohet në:

- I. Dekarbonizim
- II. Ekonomi qarkore
- III. Dekontaminim
- IV. Sisteme ushqimore të qëndrueshme
- V. Mbrojtja e biodiversitetit

Kosova ka ndërmarrë hapat e parë drejt këtyre qëllimeve përmes reformave të politikave dhe investimeve strategjike. Disa strategji kombëtare dhe masa legislative pasqyrojnë përkushtimin e Kosovës për t'u përafruar me Agjendën e Gjelbër. Në veçanti, Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019–2028 përshkruan masat për zbutje dhe ato për përshtatje që synojnë uljen e emetimeve të gazrave serrë. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, ende ekzistojnë sfida të konsiderueshme, përfshirë vonesat në miratimin e PKEK dhe boshllëqet në zbatimin e Udhërrëfyesit për Ekonomi Qarkore – të dyja kritike për tranzicionin e qëndrueshëm të Kosovës.

Një arritje e rëndësishme në legjislacionin mjedisor të Kosovës është miratimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike (Ligji nr. 08/L-250) në janar 2024⁴. Ky ligj përfaqëson një avancim të madh drejt përafrimit me obligimet ndërkombëtare për klimën dhe krijimit të një kornize për mbrojtjen e mjedisit. Në të përcaktohet një sistem për monitorim, raportim dhe verifikim (MRV), i bazuar në një qasje nga poshtë-lart, ku operatorët monitorojnë të dhënat, të cilat më pas raportohen te qeveria dhe Agjencia për

Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Ky ligj parasheh pesë dokumente kyçe në kuadër të strategjisë afatgjatë për dekarbonizim. Për më tepër, ligji përcakton detyrimin e themelimit të Këshillit Kombëtar për Klimën dhe Bordit Këshillëdhënës Shkencor. Këshilli Kombëtar

për Ndryshimet Klimatike tashmë është themeluar dhe pritet të luajë një rol vendimtar në koordinimin e politikave klimatike ndërsektoriale.

Një dispozitë e rëndësishme e ligjit i referohet CBAM-it. CBAM është dizajnuar për të siguruar kushte të barabarta mes prodhuesve evropianë, të cilët janë të detyruar të blejnë leje për emetime në kuadër të Sistemit të Tregtimit të Emetimeve në BE (ETS), dhe konkurrentëve jashtë BE-së. Në fund, ky mekanizëm do të zëvendësojë alokimin falas të lejeve si instrumentin kryesor për parandalimin e transferimit të ndotjes së karbonit. Pritet që Kosova të ndikohet më pak nga CBAM-i. Sipas Indeksit të Ekspozimit Relativ ndaj CBAM-it të Bankës Botërore, Kosova madje mund të fitojë një avantazh konkurrues në krahasim me prodhuesit mesatarë të BE-së për mallrat që eksportojnë. Kjo kryesisht për shkak të shkallës së kufizuar të eksporteve të Kosovës drejt BE-së, të cilat përbëjnë vetëm rreth 1% të BPV-së⁵.

Megjithatë, ndikimi financiar i përgjithshëm i CBAM-it në Kosovë deri në vitin 2034 parashikohet të jetë 93 milionë euro⁶: Sektorët kryesorë që pritet të preken përfshijnë hekurin dhe çelikun, aluminin dhe energjinë elektrike. Vetëm brenda sektorit të prodhimit, kostot e lidhura me CBAM-in mund të arrijnë në 36 milionë euro deri në vitin 2034.

Pavarësisht përpjekjeve të fundit për të reformuar sektorin e menaxhimit të mbeturinave, Kosova vazhdon të përballë me sfida të mëdha që pengojnë zbatimin efektiv. Miratimi i Ligjit për Mbeturinat në vitin 2022 shënoi një hap formal përpara. Megjithatë, zbatimi mbetet kryesisht joefektiv për shkak të kufizimeve të vazhdueshme financiare, mungesës së kapaciteteve teknike dhe koordinimit të fragmentuar institucional. Këto kufizime strukturore jo vetëm që vonojnë progresin, por edhe ekspozojnë një shkëputje

4 <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-adopts-first-law-on-climate-change/>

5 Deutsche Energie-Agentur (DENA). Sfidat dhe Mundësitë e Mekanizmit të korigjimit të kufirit të karbonit (CBAM) për Vendet e Ballkanit Perëndimor].

6 Ekipi Ekonomik Gjerman (GET). 2024. CBAM dhe Kosova: Implikimet ekonomike dhe përjashtimi i mundshëm për eksportet e energjisë elektrike në BE.

të thellë ndërmjet formulimit të politikave dhe zbatimit praktik. Megjithatë, disa përparime graduale tregojnë potencial për përmirësim sistematik, përfshirë zhvillimin e një sistemi online për monitorimin e menaxhimit të mbeturinave me 20 indikatorë të performancës, hartimin e Planit të Menaxhimit të Mbeturinave të Ndërtimit dhe Rrënitimit), miratimin e Strategjisë së Integruar për Menaxhimin e Mbeturinave (2024–2035) së bashku me Planin e Veprimave (2024–2026). Përderisa këto iniciativa paraqesin një vizion strategjik, potenciali i tyre transformues do të varet nga investimet e qëndrueshme, përputhshmëria ndërsektoriale dhe mekanizmat e fuqishëm të llogaridhënies për të mbyllur hendekun ndërmjet ambicies ligjore dhe realitetit në terren.

Për më tepër, Kosova vazhdon të përballet me probleme të mëdha mjedisore, veçanërisht ndotjen e ajrit dhe ujit. Vendi ka infrastrukturë të kufizuar për trajtimin e ujërave zeza dhe një varësi të lartë nga linjiti për prodhimin e energjisë elektrike, që kontribuon ndjeshëm në emetimet e CO₂.

Progresi

- *Miratimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike (Ligji Nr. 08/L-250) në janar 2024, i cili prezanton struktura gjithëpërfshirëse të qeverisjes klimatike dhe mekanizma të fuqishëm monitorimi.*
- *Themelimi i Këshillit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, i ngarkuar me koordinimin e politikave dhe veprimeve klimatike.*
- *Fillimi i procesit të hartimit të Strategjisë Afatgjatë për Dekarbonizim, një nga pesë dokumentet strategjike të parashikuara në Ligjin për Klimën.*
- *Përparime në menaxhimin e mbeturinave, përfshirë miratimin e Ligjit për Mbeturinave (2022), zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (2024–2035), dhe zhvillimin e sistemit online për monitorim me 20 indikatorë.*

Boshllëqet dhe Problemet

- *Vonesat në miratimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK), një instrument kyç*

për arritjen e objektivave të dekarbonizimit dhe tranzicionit energjetik.

- *batim i kufizuar i Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkore, që pengon avancimin drejt një ekonomie me përdorim efikas të resurseve.*
- *Zbatim i dobët i legjislationit për menaxhimin e mbeturinave, që rrjedh nga kufizimet financiare, teknike dhe institucionale.*
- *Ndotje e vazhdueshme e ajrit dhe ujit, me infrastrukturë të kufizuar për trajtimin e ujërave të zeza dhe varësi e madhe nga linjiti për prodhimin e energjisë elektrike.*
- *Kapacitete të kufizuara teknike dhe institucionale në autoritetet përkatëse për të zbatuar në mënyrë efektive masat për klimën, mbeturinat dhe biodiversitetin.*

Rekomandimet e BGF

1. Të përshpejtohet miratimi dhe operacionalizimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, duke siguruar përputhshmëri të plotë me Agjendën e Gjelbër dhe objektivat e BE-së.
2. Të fuqizohen ligjet për menaxhimin e mbeturinave duke rritur alokimet buxhetore, duke ndërtuar ekspertizë teknike dhe duke avancuar mekanizmat monitorues si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar.
3. Të zhvillohet dhe të zbatohet një plan i detajuar dhe me parashikimin e kostove për Udhërrëfyesin për Ekonomi Qarkore, me pikat kryesore, angazhim të sektorit privat dhe fushata vetëdijësuese publike.
4. Të investohet në burime të ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe përmirësim të masave për efikasitet energjetik, duke zvogëluar gradualisht varësinë nga linjiti dhe ulur emetimet e CO₂.
5. Të përmirësohen kapacitetet administrative për sistemet MRV-së, për të mbështetur zbatimin efektiv të Ligjit për Ndryshimet Klimatike.
6. Të mbështeten kompanitë për tu përgatitur për kërkesat e CBAM-it përmes asistencës teknike, trajnimeve të përshtatura dhe lehtësimit të qasjes në teknologji më të gjelbra, veçanërisht në sektorët e çelikut, aluminit dhe energjisë elektrike.

Çështjet kyçe, Boshllëqet dhe Përmirësimet e Mundshme

4

Përderisa Kosova ka ndërmarrë hapa për të përafruar politikat me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, disa sfida kritike vazhdojnë të jenë të pranishme në sektorët kryesorë. Pengesat strukturore, burimet e kufizuara financiare, mekanizmat e dobët të zbatimit dhe koordinimi i pamjaftueshëm institucional vazhdojnë të pengojnë zbatimin efektiv dhe progresin. Kjo pjesë paraqet çështjet më urgjente, boshllëqet ekzistuese në politika dhe mundësitë

konkrete për përmirësim në këto fusha: energji, klimë, transport, ekonomi qarkore, përfshirje sociale, menaxhim të mbeturinave dhe ujërave, sisteme të qëndrueshme ushqimore dhe zhvillim rural, bujqësi dhe biodiversitet. Adresimi efektiv i këtyre sfidave është thelbësor për të siguruar që tranzicioni i gjelbër i Kosovës të jetë holistik, i qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet mjedisore të BE-së dhe zotimet klimatike rajonale..

Tabla 1:

Zotimet (ME)	Detajet	Statusi/Afati kohor
Zbatimi i Strategjisë për Energji	Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2022–2031, në përputhje me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Të sigurohet konsistencë me draft PKEK.	Miratuar. Zbatimi në vazhdimësi.
Korniza Ligjore për Energji të Pastër	Krijimi i një kornize ligjore për të adresuar sfidat për një peizazh të energjisë së pastër (Ligji për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë).	Miratuar në Q2/2024; i përfunduar.
Ankandet për Energjinë e Ripërtëritshme	Mbajtja e ankandeve transparente dhe konkurruese për investimet në BRE. Përfundimi i ankandit solar prej 100 MW dhe identifikimi i vendndodhjeve për projektet e energjisë së erës dhe asaj solare.	Ankandi solar 100 MW i përfunduar (Q1/ 2024);
Projekti për bateritë për ruajtje të energjisë	Bashkëpunimi në projektin për bateritë për ruajtje të energjisë financuar nga Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCA).	Në vazhdimësi.
Ankandet për Energjinë e Erës	Nisja e një projekti për energjinë e erës me kapacitet 150 MW, i financuar nga Fondi i FMN-së për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri (RSF), sipas një skeme të Partneritetit Publiko-Privat (PPP).	Faza e parë e ankandit të parë nga dy ankandet e planifikuara për energjinë e erës filloi (Q4/2024). Faza e parakualifikimit përfundoi me tre oferta të pranuara (Q1/2025).
Projekti për Energji Solare 100 MW	Zbatimi i projektit të energjisë solare prej 100 MW, në përputhje me marrëveshjen për zhvillimin e projektit, brenda dy viteve nga nënshkrimi i kontratës.	Projekti do të vihet në funksion brenda dy viteve nga marrëveshja.

Tabela 1 paraqet një përmbledhje të angazhimeve kryesore të ndërmarra nga Ministria e Ekonomisë (ME) në kuadër të Agjendës së Gjelbër. Në të janë përfshirë veprimet e planifikuara, statusi aktual i zbatimit dhe afatet e parashikuara, duke ofruar një pasqyrë të përpjekjeve në vazhdim dhe prioritetet e ardhshme të Kosovës.

4.1 Energjia

Kosova vazhdoi të shënojë përparim në avancimin e tranzicionit energjetik gjatë vitit 2024, veçanërisht përmes investimeve në modernizimin e rrjetit, efikasitetin energjetik dhe diversifikimin e miksit energjetik. Megjithatë, varësia nga thëngjilli me kapacitete të vjetruara, barrierat rregullative dhe boshllëqet e kapaciteteve vazhdojnë të kufizojnë ritmin e reformave. Edhe pse legjislacioni i ri dhe pilot-ankandet për energji të ripërtëritshme sinjalizojnë lëvizje përpara, mbetet shumë për t'u bërë që sektori të harmonizohet me standardet e BE-së dhe Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Sipas Raportit të Progresit për vitin 2024 për zbatimin e Strategjisë së Energjisë, mund të vlerësohen këto arritje⁷:

Investime në rrjet dhe infrastrukturë: Janë realizuar investime të konsiderueshme në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, përfshirë tensionin e ulët (0.4 kV), tensionin e mesëm (35/10(20) kV) dhe nyjat e reja 110/10(20) kV të menaxhuara nga OST dhe OSSH. Këto investime kanë kontribuar në rritjen e besueshmërisë, zvogëlimin e humbjeve në shpërndarje dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike. Përmirësimet në infrastrukturën e Rrjetit të Mençur, si instalimi i matësve digjitalë dhe sistemeve IT, kanë mundësuar faturim në distancë, siguri më të lartë të të dhënave dhe operacione më efikase.

Përfitime nga efikasiteti energjetik: Masat për efikasitet energjetik (EE) të zbatuara në ndërtesat publike në nivel komunal dhe qendror kanë sjellë kursime prej 6.6 ktoe/vit. Në sektorin rezidencial, 10.727 qytetarë kanë përfituar subvencione për sisteme solare për ngrohjen e ujit, sisteme fotovoltaike për vetëkonsum dhe pajisje shtëpiake efikase. Mbështetja financiare gjithsej gjatë vitit 2024 arriti në 5,1 milionë euro, ku 7.633 përfitues janë identifikuar si familje të cënueshme ndaj ndryshimeve klimatike⁸.

Ngrohja Qendrore dhe Kogjenerimi: Investimet e vazhdueshme në ngrohje qendrore kanë çuar në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të "Termokosit" në Prishtinë, përfshirë instalimin e pajisjeve matëse. Është finalizuar një studim fizibiliteti për dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit në TC "Kosova B" nga 140 MWth në 280 MWth.

Zhvillimi i Energjisë së Ripërtëritshme: Kuvendi ka miratuar Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme, i publikuar në Gazetën Zyrtare më 2 maj 2024. Pas kësaj, më 31 maj është përmbyllur me sukses ankandi konkurrues për 100 MW energji solare. Ankandi i dytë për 100 MW kapacitet nga era është lansuar në dhjetor 2024. Gjithashtu, janë hartuar katër standarde të reja profesionale për arsimim në sektorin e energjisë, të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës.

Liberalizimi i Tregut dhe Integrimi Rajonal: Kosova bëri përparime në bashkëpunim rajonal përmes operacionalizimit të tregjeve të ditës së nesërme dhe brenda të së njëjtës ditë të energjisë elektrike përmes ALPEX, përfshirë ankandin e parë të tregut brenda të së njëjtës ditë. Megjithatë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka shpallur hapjen e tregut për qershor 2024 me përfshirje minimale të hisedarëve, duke lënë bizneset të papërgatitura dhe duke ngritur shqetësime për gatishmërinë institucionale dhe transparencën rregullative.

Mbështetje për Konsumatorët e Cënueshëm: Familjet e cënueshme kanë vazhduar të përfitojnë subvencione për energjinë elektrike në vitin 2024 përmes një programi të ri të mbrojtjes. Megjithatë, mungesa e një përkufizimi ligjor për varfërinë energjetike dhe të dhënat e paqëndrueshme lokale kufizojnë hartimin e mbështetjes së synuar. Financimi mbetet i kufizuar dhe shumë komuna nuk kanë kapacitet për të zbatuar asistencën në mënyrë efektive, duke theksuar boshllëqe më të thella në qeverisje dhe financim në ofrimin e një tranzicioni të drejtë energjetik. Arritjet e objektivave të vitit 2024 janë të paraqitura në tabelën dhe grafikun më poshtë:

7 Raporti i Progresit 2024 i Programit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022–2025. Burimi: <https://me.rks-gov.net/en/energy-2/>

8 Intervistë me Udhëheqësin e Departamentit të Energjisë/Ministria e Ekonomisë

Table 2:

	2022	2023	2024
Objektivi 1	59.2%	51.8%	45%
Objektivi 2	68.3%	51.3%	42%
Objektivi 3	62.8%	51.0%	59%
Objektivi 4	80.0%	60.0%	47%
Objektivi 5	98.0%	45.0%	91%
Totali i zbatimit të objektivave	73.7%	51.8%	57%

Figura 1: Përqindja e zbatimit të objektivit janar – dhjetor 2024




Tabela 2 dhe Figura 1 tregojnë progresin e zbatimit të pesë objektivave energjetik në Kosovë nga viti 2022 deri në vitin 2024. Ndërsa zbatimi mesatar në përgjithësi shënoi rënie, në vitin 2024 kishte rezultate të përziera: Objektivi 5 arriti 91%, ndërsa të tjerët mbetën nën 60%. Të dhënat vënë në pah progresin jo të barabartë dhe nevojën për koordinim më të fortë institucional.

Sfidat Strukturore dhe Operative

Pavarësisht këtyre përparimeve, sektori i energjisë në Kosovë vazhdon të përballet me sfida të vazhdueshme

- Varësia nga qymyri: Qymyri mbetet burimi kryesor i energjisë në Kosovë,

duke përbërë 90,4%⁹ të prodhimit të energjisë elektrike, duke e bërë vendin ndër më të varurit nga qymyri në nivel global, së bashku me Serbinë (67%)¹⁰ dhe Bosnje dhe Hercegovinën (65%)¹¹. Largimi gradual nga linjiti do të kërkojë reforma të konsiderueshme strukturore dhe ekonomike.

- Vonesat në legjislacion sekondar dhe kapacitetet institucional: Njësia e sapo themeluar për BRE brenda Ministrisë së Ekonomisë ka mungesë të stafit adekuat, ekspertizës teknike dhe mbështetjes buxhetore për të udhëhequr zbatimin e projekteve. Vonesat në miratimin e legjislacionit sekondar mbështetës

9 Zyra e Rregullatorit të Energjisë. 2024. Burimi: Raporti Vjetor për 2024

10 Qendra e Përbashkët e Kërkimeve. 2024. Tranzicioni i Gjelbër dhe Specializimi i Mençur në Ballkanin Perëndimor

11 Eurostat. 2024. Burimi: <https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?oldid=641466&utm>

pengojnë edhe më shumë aprovimin e investimeve dhe ngadalësojnë integrimin e energjisë së ripërtëritshme në rrjet.

- Progres i kufizuar në financimin dhe buxhetimin e gjelbër: Përderisa Kosova ka nisur diskutime rreth mekanizmave të financimit të gjelbër, ende mungon një qasje e strukturuar për integrimin e qëndrueshmërisë në planifikimin buxhetor. Shpenzimet publike për programet mjedisore dhe të tranzicionit energjetik mbesin të pamjaftueshme.
- Praktikat industriale të vjetruara dhe kufizimet rregullatorë: Përdoruesit industrialë të energjisë vazhdojnë të mbështeten në teknologji joefikase. Komplexiteti rregullator dhe konkurrenca e ulët në tregun e energjisë dekurajojnë investimet e sektorit privat në të ripërtëritshmet. Ende mungon një udhërrëfyes i qartë për liberalizimin e tregut, përfshirë stimujt dhe mekanizmat për ndarjen e rrezikut..

Siguria Energjetike dhe Performanca e Tregut

- Në dhjetor 2024, Kosova prodhoi një sasi bruto të energjisë elektrike prej 899,56 GWh, ndërsa konsumi arriti në 637,06 GWh, që paraqet një rritje prej 4,75% krahasuar me dhjetorin 2023.
- Pjesëmarrja e energjisë alternative në konsumin total ishte 7,86%¹².
- Importet arritën në 475,35 GWh, ndërsa eksportet ishin gjithsej 144,35 GWh, duke theksuar rëndësinë e adresimit të humbjeve teknike dhe komerciale për besueshmërinë e sistemit¹³.
- Operatori i sistemit të transmetimit, KOSTT, duhet të sigurojë përputhje të plotë me Marrëveshjen e Koneksionit me ENTSO-E, me devijime zero për të ruajtur stabilitetin ndërkufitar të rrjetit. Për më tepër, miratimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) mbetet nevojë urgjente dhe duhet të harmonizohet me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë¹⁴.

Aspektet e Tranzicionit të Drejtë

Sektori i thëngjillit mbetet një punëdhënësi i madh në Kosovë. Nga përafërsisht 138.000 vende pune të lidhura me thëngjillin në Ballkanin Perëndimor, 1,4% të të punësuarve në Kosovë janë të lidhur me këtë sektor, që është dyfish më shumë se në Poloni (0,7%)¹⁵. Pa një politikë të strukturuar për tranzicion të drejtë, largimi nga thëngjilli mund të ndikojë në mënyrë joproporcionale tek punëtorët dhe komunitetet.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të adresuar boshllëqet si në performancë ashtu edhe në strukturë, BGF rekomandon më sa vijon:

1. *Sigurimi i miratimit me kohë të kornizave strategjike: Përsheptimi i miratimit të PKEK dhe legjislacionit sekondar mbështetës për të mundësuar investime dhe planifikim të harmonizuar me BE-në.*
2. *Rritja e financimit për energjinë e ripërtëritshme: Angazhim për një rritje minimale prej 15% në vit të alokimeve buxhetore për projektet e energjisë së ripërtëritshme gjatë pesë viteve të ardhshme.*
3. *Fuqizimi i Njesisë për BRE: Zgjerimi i kapaciteteve të njesisë me ekspertë teknikë, këshilltarë ligjorë dhe planifikues financiarë për të hartuar dhe zbatuar skema stimuluese.*
4. *Miratimi i legjislacionit të plotë për energjinë: Miratimi i pakos së plotë të ligjeve të ndryshuara për energjinë për të siguruar pajtueshmëri me Pakon për integrimin e energjisë elektrike dhe Pakon për energji të pastër.*
5. *Përsheptim i Liberalizimit të Tregut: Hartimi i një udhërrëfyesi të qartë për liberalizim, i shoqëruar me reforma rregullatore, mjete për zbutjen e rrezikut dhe komunikim me bizneset e prekura.*
6. *Krijimi i Mekanizmave për Buxhetim të Gjelbër: Institucionalizimi i kriterëve të*

12 Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2024. Burimi: <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8481>

13 Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2024. Burimi: <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8481>

14 Komisioni Evropian. 2024. Burimi: Raporti për Kosovën, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

15 Qendra e Përbashkët e Kërkimeve. 2024. Burimi: Tranzicioni i Gjelbër dhe Specializimi i Mençur në Ballkanin Perëndimor

qëndrueshmërisë në buxhetim publik për të mundësuar investime afatgjata në efikasitet energjetike dhe infrastrukturë të ripërtëritshme.

7. *Forcimi i Partneriteteve Publiko-Private (PPP):* Nxjtja e bashkëpunimit me investitorë privatë dhe partnerë ndërkombëtarë për realizimin e projekteve të infrastrukturës së gjelbër, veçanërisht në transmetim, ruajtje dhe zhvillim të rrjetit të mençur.
8. *Zhvillimi i Kornizës për Tranzicion të Drejtë:* Krijimi i një plani kombëtar për mbështetjen e punëtorëve dhe komuniteteve të prekura nga mbyllja e sektorit të thëngjillit, përfshirë programe për rikualifikim dhe masa për mbrojtje sociale.

4.2 Klima

Kosova ka krijuar bazën ligjore për politikën klimatike, por mekanizmat institucionalë dhe operativ të nevojshëm për zbatim mbesin të pazhvilluar. Miratimi i Ligjit për Ndryshimet Klimatike (Nr. 08/L-250) në janar 2024 ofron një kornizë formale për monitorimin e emetimeve, koordinimin e politikave dhe krijimin e instrumenteve për planifikim strategjik¹⁶. Megjithatë, vendi nuk ka një objektiv të detyrueshëm për neutralitet klimatik deri në vitin 2050 dhe asnjë nga pesë strategjitë e detyrueshme sipas ligjit – si Strategjia për Dekarbonizim dhe Strategjia për Përshtatje – nuk është finalizuar apo miratuar.

Statusi i Planifikimit dhe Legjislacionit

NDC, e miratuar në mars të 2025, shënon hyrjen formale të Kosovës në strukturat ndërkombëtare të raportimit për klimën. NDC përcakton një rrugë për uljen e emetimeve të gazrave serrë deri në 42% deri në vitin 2030, me kusht të mbështetjes financiare të jashtme. Ky skenar reduktimi përfshin energjinë, transportin, ndërtesat rezidenciale, mbeturinat, bujqësinë, pylltarinë dhe shfrytëzimin e tokës.

Fizibiliteti financiar i NDC-së mbetet i pasigurt. Kosova parasheh një hendek në investime klimatike prej 2,9 miliardë euro deri në vitin 2030. Megjithatë, qeveria aktualisht ndan më pak se 0,5% të buxhetit të vendit për programe mjedisore dhe klimatike, krahasuar me mesataren e BE-së prej rreth 2%. Pa rritje dhe qëndrueshmëri në investime publike, zbatimi i objektivave të NDC-së është i pamundur¹⁷.

Ligji për Klimën kërkon edhe krijimin e një sistemi kombëtar për MRV, si dhe themelimin e Këshillit Kombëtar për Klimën. Ndonëse këto trupa janë iniciuar, ato ende nuk kanë kapacitete operative dhe staf të dedikuar. Asnjë regjistër kombëtar apo bazë e të dhënave për emetimet nuk është vënë ende në dispozicion të publikut apo institucioneve ndërsektoriale.

Sfidat në zbatim

Aftësia e Kosovës për të zbatuar politika klimatike është e limituar nga kufizimet administrative, financiare dhe rregullative::

- *Mungesa e objektivave afatgjata:* Nuk ekziston një udhërrëfyes formal për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050, dhe mungojnë objektiva të ndërmjetëm apo kufij sektorialë të emetimeve
- *Koordinim i Dobët Ndërmnistror* Ministria e Ekonomisë menaxhon investimet në infrastrukturën energjetike, ndërsa Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës¹⁸ mbikëqyr politikat klimatike. Përgjegjësitë e tyre shpesh dyfishohen, duke shkaktuar vonesa në zbatim dhe duke dëmtuar koherencën e politikave.
- *Kapacitet i Ulët Rregullator:* Divizioni për Inspektim Mjedisor ka vetëm 20 inspektorë për të mbuluar të gjitha shkeljet që lidhen me mjedisin, ujin dhe natyrën në Kosovë¹⁹. Sa për ilustrim, Mali i Zi ka 35 inspektorë në nivel vendi, ndonëse ka një popullatë më të vogël. Ky deficit në zbatim kontribuon

16 Intervistë me Zyrën për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit

17 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. 2025. Burimi: <https://mmphi.rks-gov.net/News/NewsArticle?ArticleID=2464>

18 Intervistë me Drejtorin Ekzekutiv të OJQ-së "EcoZ"

19 Intervista e përmendur më sipër.

në shkallë të lartë të mosrespektimit të standardeve për emetimet industriale dhe zhvillimin e projekteve ²⁰.

- *Integrim i Pamjaftueshëm i Rreziqeve Klimatike Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) shpesh kryhen në mënyrë sipërfaqësore ose anashkalohen plotësisht. Projektet infrastrukturore dhe energjetike shpesh zhvillohen pa analizë klimatike apo llogaritje të emetimeve.*
- *Presion në Rritje mbi Infrastrukturën: Një rritje prej 400% në import të pajisjeve për klimatizim gjatë vitit 2024 tregon kërkesë të shtuar për rregullim të temperaturës në amvisëri²¹. Ky trend reflekton ekspozimin ndaj ekstremeve të nxehtësisë dhe varësinë e vazhdueshme nga termocentralet me linjit, që rrisin ngarkesën në rrjet dhe emetimet gjatë orëve të pikut.*
- *Pjesëmarrje e Kufizuar Qytetare: Konsultimet që lidhen me politikat klimatike rrallë përfshijnë organizatat e shoqërisë civile. Nuk ekziston një platformë këshillëdhënëse formale për OJQ-të mjedisore dhe qasja e publikut në të dhënat për emetimet për momentin nuk është e mundur.*

Profil i Emetimeve dhe Ekspozimi

Kosova ka emetuar rreth 8,46 milionë tonë ekuivalent të CO₂ në vitin 2022. Vetëm dioksidi i karbonit përbënte mbi 80% të totalit²². Sektori i energjisë është burimi kryesor i emetimeve për shkak të përdorimit të linjitet, i ndjekur nga transporti dhe ngrohja rezidenciale. Kosova është gjithashtu e ekspozuar ndaj CBAM-it, veçanërisht në sektorët e energjisë elektrike dhe metaleve industriale, ndonëse volumi aktual i eksporteve drejt BE-së (1% e BPV) e kufizon ndikimin afatshkurtër fiskal.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të adresuar këto zbrazëtira, BGF propozon këto masa:

1. *Vendosja e Objektivave të Detyrueshme për Klimën: Hartimi i legjislacionit që e detyron Kosovën të arrijë emetime neto-zero deri në vitin 2050. Vendosja e objektivave të ndërmjetëm për vitet 2030 dhe 2040, të mbështetura nga monitorimi vjetor i emetimeve.*
2. *Finalizimi dhe Operacionalizimi i Strategjive Klimatike Përfundimi dhe miratimi i Strategjisë për Dekarbonizim dhe Strategjisë për Përshtatje. Secila strategji duhet të përfshijë vlerësime të kostove, objektiva sektorialë, instrumente financimi dhe afate zbatimi.*
3. *Rritja e Investimeve Publike në Programet Klimatike: Rritja e shpenzimeve publike për programet klimatike dhe mjedisore në të paktën 1% të BPV-së deri në vitin 2027. Alokimi i fondeve për infrastrukturë komunale për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, sisteme për monitorimin e emetimeve dhe bujqësi reziliente ndaj klimës*
4. *Themelimi i një Autoriteti Qendror Koordinues. Themelimi i Sekretariatit për Klimë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për të koordinuar të gjithë planifikimin, buxhetimin dhe zbatimin në nivel ndërministror.*
5. *Zgjerimi i Stafit për Inspektim dhe Zbatim: Rritja e numrit të inspektorëve për mjedis në nivel vendi, nga 20 në të paktën 40 deri në vitin 2026. Sigurimi i mjeteve digjitale për gjurmimin e emetimeve, auditimin e projekteve dhe ndjekjen e zbatimit dhe masave.*
6. *Detyrimi dhe Zbatimi i VNM-ve për të Gjitha Projektet e Mëdha: Kërkimi i vlerësimeve të rrezikut klimatik dhe projeksioneve të gazërave serrë për të gjitha projektet infrastrukturore publike dhe private me vlerë mbi 1 milion euro.*
7. *Përgatitja për Integrimin e Çmimoreve për Karbon: Fillimi i hartimit të një udhërrëfyesit për futjen e një mekanizmi të çmimores për karbon në sektorët e energjisë dhe*

20 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. 2025. Burimi: <https://mmphi.rks-gov.net/Others/Department?DepartmentID=5>

21 Reuters. 2024. Burimi: <https://www.reuters.com/world/europe/balkans-new-love-air-conditioning-strains-grid-temperatures-soar-2024-08-14/>

22 Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë. 2022. Burimi: <https://www.iea.org/data-and-statistics>

të industrisë. Përshtatja e politikave të ardhshme me standardet e Sistemit të Tregtimit të Emetimeve (ETS) të BE-së.

8. *Krijimi i Mekanizmave për Pjesëmarrje Qytetare*: Themelimi zyrtar i një Platformë Këshillimore për Klimën për të përfshirë përfaqësues nga shoqëria civile, academia dhe komunat në hartimin dhe shqyrtimin e politikave klimatike.

4.3 Transporti

Sektori i transportit në Kosovë vazhdon të jetë në një fazë tranzitore, i karakterizuar nga përpjekje për planifikim strategjik në letër, por me progres të ngadalshëm në zbatim. Miratimi i Strategjisë për Transport Multimodal 2023–2030 dhe aprovimi i Listës së Unifikuar të Projekteve në vitin 2024 sinjalizojnë synimin për të modernizuar infrastrukturën dhe për t'u përafruar me acquis e BE-së. Megjithatë, afatet e zbatimit, pajtueshmëria mjedisore dhe kapacitetet institucionale nuk kanë ecur në të njëjtin ritëm me këto angazhime.

Zhvillimet në Politika dhe Projekte

Në dhjetor 2023, Qeveria e Kosovës miratoi zyrtarisht Strategjinë për Transport Multimodal (MMTS) së bashku me planin e veprimit, ndërsa më pas, në qershor 2024, Komiteti për Planifikim Strategjik miratoi Listën e Unifikuar të Projekteve për sektorin e transportit²³. Këto korniza janë hartuar për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe për të siguruar koherencë të politikave në transportin rrugor, hekurudhor dhe urban.

Në nivel projekti po vazhdojnë përpjekjet për të rehabilituar korridoret kryesore rajonale, duke përfshirë hekurudhën Prishtinë–Durrës dhe rrugën Prizren–Tetovë. Në shkurt të vitit 2024, Kosova nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për të mobilizuar deri në 400 milionë euro në deri në vitin 2027 mbështetje të modernizimit të infrastrukturës dhe projekteve të mobilitetit të gjelbër²⁴.

Pavarësisht këtyre kornizave dhe

marrëveshjeve, zbatimi ka qenë jokonsistent:

- Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektet kryesore të transportit mbesin të papërfunduara ose të vjetruara, duke penguar miratimin rregullativ dhe duke shkelur standardet e BE-së
- Afatet e projekteve shtyhen rregullisht, ndërsa rregullimet e kostove janë të shpeshta për shkak të planifikimit të dobët, vonesave në shpronësim dhe dështimeve në koordinimin me kontraktorët.

Kufizimet kryesore

- *Kapacitet i kufizuar në transportin urban*: Qytete të mëdha si Prishtina dhe Gjlani operojnë me flotë autobusësh të vjetruar dhe mbulim të kufizuar të linjave. Asnjë komunë nuk ka miratuar një Plan të Mobilitetit të Qëndrueshëm i Urban (SUMP), që paraqet detyrim ligjor.
- *Boshllëqet Institucionale*: Përgjegjësitë administrative për infrastrukturën e transportit janë të ndara në disa nivele të qeverisjes, pa mekanizma efektivë koordinimi. Mbikëqyrja e projekteve mbetet e centralizuar, duke i lënë komunat me më pak autoritet dhe fleksibilitet buxhetor për të menaxhuar planifikimin lokal të mobilitetit.
- *Mungesë e Integritetit Klimatik*: Rezilienca klimatike nuk përfshihet në mënyrë sistematike në planifikimin e infrastrukturës rrugore apo hekurudhore. Projektet e transportit nuk vlerësohen për ekspozim ndaj valëve të të nxehtit, përmblytjeve apo potencialit për reduktim afatgjatë të emetimeve.
- *Mungesë e zhvillimit të mjeteve alternative të transportit*: Kosova nuk ka asnjë linjë funksionale të autobusëve elektrikë, as stimuj kombëtarë për integrimin e automjeteve elektrike (EV), dhe infrastrukturë minimale për transport jo-motorik. Janë më pak se 10 stacione publike për mbushjen e EV në të gjithë vendin, asnjëra prej të cilave nuk është e integruar plotësisht në rrjetet komunale të mobilitetit.

23 Komisioni Evropian. 2024. Burimi: Raporti për Kosovën, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_eng

24 BERZH. 2025. Burimi: <https://www.ebrd.com/home/news-and-events/news/2024/ebd-strengthens-support-to-kosovos-governmental-institutions.html>

- Vonesa në reforma ligjore: Ligji për Transportin, i cili është aktualisht në rishikim, nuk pritet të finalizohet para shtatorit 2025. Në formën aktuale, ligji nuk përmban dispozita për menaxhim digjital të trafikut, përcjellje të emetimeve apo mbështetje për modelet e mobilitetit të përbashkët.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të përafruar sektorin e transportit të Kosovës me objektivat e Agjendës së Gjellbër dhe standardet e BE-së për mobilitet, rekomandohen këto veprime:

1. Finalizimi i Reformës Ligjore në Afat: Përfundimi dhe miratimi i Ligjit të rishikuar për Transportin deri në Q3 2025. Ligji duhet të përfshijë dispozita të qarta për standarde të shërbimeve të transportit publik, zona me emetime të ulëta, planifikim të bazuar në të dhëna, mbështetje për sisteme të mobilitetit elektrik dhe të përbashkët.
2. Detyrimi për plane të lëvizshmërisë urbane: Kërkesa që të gjitha qytetet me mbi 50.000 banorë të miratojnë dhe zbatojnë Plane të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (SUMP) deri në vitin 2026, përfshi strategjitë e integruara për transport jo-motorik dhe reduktim të emetimeve
3. Rritja e investimeve në transportin publik: Alokimi i së paku 25% të fondeve vjetore për infrastrukturën e transportit për zhvillimin e transportit publik deri në vitin 2026, me fokus në autobusë elektrikë, sisteme të transportit të shpejtë me autobusë (BRT) dhe sisteme të mençura biletimi.
4. Krijimi i kornizës për stimulimin e EV: Hartimi i një pakoje kombëtare stimuljsh për integrimin e EV, përfshirë përjashtim nga TVSH-ja, taksë zero për importin e automjeteve elektrike dhe pajisjeve për mbushje, infrastrukturë të dedikuar për EV në të gjitha komunat deri në vitin 2027.
5. Zbatimi i Strategjisë ITS: Operacionalizimi i një Strategjie Kombëtare për Sistemet e mençura të Transportit (ITS) që përfshin vendosjen graduale të semaforëve

të mençur, sisteme për informim në kohë reale për pasagjerët dhe ndarjen e të dhënave të transportit ndërmjet komunave dhe autoriteteve kombëtare.

6. Forcimi i mbikëqyrjes mjedisore për projektet e transportit: Të bëhen të detyrueshme ekzaminimi (screening) klimatik dhe vlerësimet e ndikimit në mjedis për të gjitha projektet infrastrukturore me vlerë mbi 2 milionë euro. Themelimi i një paneli për shqyrtimin e VNM-së brenda MMPHI-së me ekspertizë në sektorin e transportit.

7. Përmirësimi i infrastrukturës për mobilitet ndërkufitar: Prioritizimi i përfundimit të lidhjeve rajonale hekurudhore dhe rrugore me Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Serbinë deri në vitin 2027.

4.4 Ekonomia qarkore

Kosova ka prezantuar instrumente politikash që e njohin ekonominë qarkore si prioritet kombëtar, më së shumti me miratimin e Udhërrëfyesit për Ekonomi Qarkore. Megjithatë, zbatimi mbetet sipërfaqësor. Gjenerimi i mbeturinave vazhdon të tejkalojë kapacitetet e infrastrukturës për riciklim dhe ripërdorim, ndërsa zbatimi i parimeve të ekonomisë qarkore mungon në prokurim, dizajn të produkteve dhe procese industriale. Nuk janë vendosur indikatorë të matshëm për tranzicionin, dhe objektivat kombëtare për ripërdorim apo rikuperim të materialeve nuk janë të përcaktuara në legjislacion²⁵.

Peizazhi politik dhe boshllëqet institucionale

Udhërrëfyesit për Ekonomi Qarkore, ndonëse i miratuar, i mungon një plan veprimi shoqërues me afate kohore, burime financimi dhe role të përcaktuara institucionale. Kjo ka çuar në zbatim të fragmentuar, veçanërisht në nivelin komunal, ku qeveritë lokale nuk kanë fonde dhe kapacitete për të zhvilluar sisteme për ripërdorim apo për të zbatuar ndarjen e mbeturinave. Për më tepër, nuk ekzistojnë obligime ligjore që kërkojnë përfshirjen e grupeve të marginalizuara, si mbledhësit e mbeturinave apo kooperativat e udhëhequra nga gratë në skemat e ekonomisë qarkore. Kjo mungesë e mbështetjes ligjore dhe financiare

25 BERZH. 2025. Burimi: <https://www.ebrd.com/home/news-and-events/news/2024/ebird-strengthens-support-to-kosovos-governmental-institutions.html>

minon potencialin social dhe mjedisor të reformave për ekonominë qarkore.

Performanca sektoriale

- *Menaxhimi i mbeturinave:* Aktualisht riciklohen vetëm 2,5% të totalit të mbeturinave komunale të ngurta. Ndarja në burim nuk praktikohet në mënyrë sistematike. Shumica e mbeturinave dërgohen në deponi, përfshirë materiale të përshtatshme për ripërdorim apo përdorim për qellim tjetër industrial. Sistemi i Rimbursimit të Depozitës (DRS), në zhvillim e sipër, ende nuk është funksional.
- *Përfshirja e sektorit privat:* Sektori privat shfaq pjesëmarrje të ulët në praktikat qarkore. Nuk ekzistojnë stimuj tatimorë, subvencione apo programe njohjeje për bizneset që reduktojnë përdorimin e materialeve apo zbatojnë modele qarkore. Kërkesat për prokurim të gjelbër nuk janë të detyrueshme ligjorisht në tenderët publikë.
- *Instrumentet e Financimit:* Financimi për investime në ekonomi qarkore është i kufizuar. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) ka ndarë disa grante për aplikues për teknologji të gjelbra, por nuk është krijuar asnjë dritare e dedikuar për financimin e ekonomisë qarkore. Buxhetet komunale nuk përmbajnë alokime për parandalimin e mbeturinave apo infrastrukturë për ripërdorim.
- *Shoqëria civile dhe përfshirja ndërkombëtare:* Edhe pse Kosova është anëtare e Bashkimit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), OJQ-të mjedisore të Kosovës mungojnë në rrjetet globale kyçe të ekonomisë qarkore, si BioNet. Kjo kufizon qasjen në ndërtim kapacitetesh, financim dhe platforma për avokim.

Pengesat për progres

- Nuk ekziston ndonjë obligim ligjor për bizneset apo komunat që të përmbushin pragje për rikuperim apo riciklim.
- Qeveritë lokale nuk kanë kapacitete teknike dhe financiare për të zbatuar praktikat e ekonomisë qarkore.
- Mandatet institucionale mbivendosen ndërmjet MMPHI-së, Ministrisë së

Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, pa një trupë udhëheqëse të vetme përgjegjëse për koordinim.

- Mungesa e të dhënave të besueshme për rrjedhat materiale industriale pengon vlerësimet bazë dhe monitorimi.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të kaluar nga koncepti në zbatim, Kosova duhet të miratojë një kornizë ligjore të detyrueshme dhe të rrisë investimet e synuara. Veprimet e rekomanduara përfshijnë:

1. *Miratimi i një Plani veprimi me objektiva detyruese:* Zhvillimi dhe zbatimi i një Plani kombëtar të veprimit për ekonominë qarkore me objektiva të qarta për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim sipas sektorëve. Përfshirja e një mekanizmi për zbatim dhe raportim vjetor të detyrueshëm të progresit.
2. *Miratimi i legjislacionit për përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesve:* Miratimi dhe zbatimi i ligjeve për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) për paketimin, pajisjet elektrike dhe elektronike dhe tekstin. Kërkesa për deklarime vjetore nga prodhuesit e regjistruar për mbledhjen e materialeve dhe normat e riciklimit.
3. *Krijimi i stimuljeve financiarë për modelet qarkore të biznesit:* Krijimi i një dritareje të dedikuar brenda FKEE-së ose një Fondi të ri për Inovacion në Ekonominë Qarkore, që ofron grante dhe kredi me interes të ulët për eficiencë të materialit, minimizim të mbeturinave dhe dizajn ekologjik.
4. *Të bëhet detyrim ligjor prokurimi i gjelbër:* Ndryshimi i ligjit për prokurim publik për të kërkuar kriteret qarkore në të gjitha tenderët kombëtarë dhe komunalë mbi 50.000 euro. Ofrimi i trajnimeve dhe mjeteve për zyrtarët e prokurimit për të vlerësuar ofertat qarkore.
5. *Fuqizimi i kapaciteteve të qeverisjes lokale:* Ofrimi i asistencës teknike dhe mbështetjes buxhetore për komunat për të zhvilluar dhe zbatuar strategji lokale për ekonominë qarkore,

përfshirë infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave dhe qendrat për ripërdorim.

6. *Zgjerimi i lidhjeve të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare: Mbështetje për OJQ-të kosovare për t'u anëtarësuar në rrjete ndërkombëtare mjedisore dhe krijimi i një platforme kombëtare të shoqërisë civile për monitorimin e ekonomisë qarkore dhe kontribut në politika.*
7. *Krijimi i një baze kombëtare të të dhënave për rrjedhat materiale: Ngarkimi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës me mbledhjen e të dhënave të detajuara për inputet materiale, përdorimin dhe trajtimin pas konsumit për të vendosur baza kombëtare dhe për të formësuar prioritetet sektoriale.*

4.5 Përfshirja

Përfshirja mbetet një dimension i integruar dobët në tranzicionin mjedisor të Kosovës. Një nga parimet kryesore udhëzuese të BE-së për zhvillim të qëndrueshëm – angazhimi për “të mos e lënë askënd prapa” – kërkon përfshirjen e të gjitha segmenteve të shoqërisë, veçanërisht atyre më të cënuarve, në veprimet klimatike dhe tranzicionin e gjelbër. Megjithatë, në Kosovë, ky parim ende nuk pasqyrohet në mënyrë domethënëse në strategjitë aktuale për klimën apo energjinë. Përfshirja trajtohet si një mendim i mëvonshëm dhe jo si një shtyllë themelore²⁶.

Mungesa e përkufizimeve të qarta, mekanizmave të synuar dhe mandateve institucionale nënkupton se komunitetet e margjinalizuara rrezikojnë të përjashtohen nga përfitimet e tranzicionit të gjelbër. Politikat aktuale për klimën dhe energjinë nuk përmbajnë mekanizma të synuar për përfshirjen e komuniteteve të margjinalizuara, amvisërive me të ardhura të ulëta dhe hisedarëve të shoqërisë civile në planifikim apo zbatim. Pa përkufizime më të qarta,

kritere për pranueshmëri apo mandate institucionale, tranzicioni i gjelbër rrezikon të forcojë pabarazitë ekzistuese në qasjen në energji, pjesëmarrje dhe financim.

Boshllëqet në politika dhe në të dhëna

Kosova ende nuk ka përcaktuar një përkufizim ligjor të varfërisë energjetike, duke e bërë të pamundur hartimin e programeve të synuara për mbrojtje ose të subvencioneve përtej sistemit aktual të mbështetjes së bazuar në vlerësimin e gjendjes materiale për veteranët e luftës dhe përfituesit e ndihmës sociale. Si rezultat, vlerësohet se rreth 43% të amvisërive kanë vështirësi të mbulojnë kostot e ngrohjes dhe energjisë elektrike²⁷, ndërsa 25,4% klasifikohen si të varfër në aspektin energjetik sipas standardeve të Bankës Botërore (shpenzojnë mbi 10% të të ardhurave për energji)²⁸. Asnjë institucion qeveritar aktualisht nuk është përgjegjës për monitorimin apo përditësimin e rregullt të këtyre të dhënave.

Edhe pse PKEK 2025–2030 e njeh varfërinë energjetike dhe bën thirrje për një “skemë për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm”, nuk është bërë asnjë përparim në operacionalizimin e saj. Autoritetet lokale nuk kanë udhëzime apo mjete financiare për të zhvilluar programe për klimën apo energjinë të bazuara në përfshirje.

Pengesat për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse

- *Ndërgjegjësim i kufizuar publik: Edukimi mjedisor dhe fushatat e ndërgjegjësimi nuk janë zgjeruar përtej pilot-projekteve. Qytetarët kryesisht nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre sipas skemave për efikasitet energjetike apo për rolin e tyre të mundshëm në vendimmarrjen klimatike.*
- *Kapacitet jo të barabarta komunale: Shumica e komunave nuk kanë departamente për planifikim mjedisor dhe mbështeten në staf administrativ të përgjithshëm për zbatimin e politikave të*

26 Komisioni Evropian. 2024. Burimi: Raporti për Kosovën, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

27 Balkan Green Foundation. 2025. Raporti Kombëtar mbi lidhjen midis varfërisë energjetike, tranzicionit energjetik dhe komuniteteve energjetike në zonat rurale dhe rolin e tyre në rinjve në Kosovë.

28 Banka Botërore. 2019. Analizë e varfërisë dhe shpërndarjes së varfërisë në energji elektrike dhe mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm në Kosovë.

gjelbra. Vetëm disa komuna kanë marrë trajnim të synuar për përfshirje, barazi klimatike apo ofrim të qëndrueshëm të shërbimeve.

- Qasja në financa: Organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht ato që përfaqësojnë gratë, të rinjtë apo grupet minoritare, raportojnë vështirësi në qasjen në fonde kombëtare apo ndërkombëtare për mjedisin. Edhe pse ekzistojnë disa skema grantesh (p.sh. përmes KCSF), shtrirja dhe buxheti i tyre janë të kufizuara, dhe financimi nuk e ka përfshirjen si prioritet në programimin mjedisor²⁹.
- Qeverisje e fragmentuar: Nuk ekziston një kornizë kombëtare për të integruar qeverisjen pjesëmarrëse në vendimmarrjen mjedisore. Konsultimi me qytetarët është në diskrecion të plotë, dhe pak ministri apo komuna operojnë mekanizma për komente (feedback) apo platforma për planifikim pjesëmarrës.

Programet si EDI Plus (2020–2023), të financuara nga Agjencia Austriake për Zhvillim, kanë treguar se investimet e synuara në përfshirjen e komuniteteve minoritare dhe dialogun lokal mund të përmirësojnë qeverisjen gjithëpërfshirëse³⁰. Megjithatë, mësimet nga këto iniciativa nuk janë institucionalizuar. Nuk ka pasur përsëritje apo zgjerim të programimit mjedisor me fokus në përfshirje në nivel kombëtar.

Për më tepër, Kosovës i mungojnë të dhënat e ndara sipas të ardhurave, gjinisë, etnisë apo aftësisë së kufizuar në shumicën e sektorëve mjedisorë, duke e bërë të vështirë matjen e përfitimeve nga subvencionet publike, programet për efikasitet energjetike ose masat për përshtatje ndaj klimës.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të siguruar që tranzicioni i gjelbër i Kosovës të jetë gjithëpërfshirës dhe të mos lërë prapa popullatat e cënueshme, rekomandohen këto veprime:

1. Përcaktimi me ligj dhe monitorimi i varfërisë energjetike: Vendosija e një përkufizimi zyrtar për varfërinë energjetike, të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, dhe caktimi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës si organ përgjegjës për monitorim. Përditësimi vjetor i të dhënave për energjinë në nivel amvisërisht dhe ndarja sipas gjinisë, të ardhurave dhe vendndodhjes.
2. Funkcionalizimi i një skeme për mbrojtjen e konsumatorëve të cënueshëm: Dizajnimi dhe zbatimi i një programi për subvencione dhe mbështetje për amvisëritë e varfra në energji, duke përfshirë zbritje në fatura, përmirësime të pajisjeve dhe shërbime këshilluese. Zbatimi i detyrueshëm përmes kornizës së zbatimit të PKEK.
3. Zgjerimi i kapaciteteve dhe financimit komunal: Ofrimi i granteve të drejtpërdrejta dhe asistencës teknike për komunat për të zbatuar programe klimatike gjithëpërfshirëse. Kërkesa që çdo komunë të zhvillojë një strategji lokale për përfshirje si pjesë e dokumenteve të saj për planifikim të klimës apo energjisë.
4. Integrimi i përfshirjes në financimin e gjelbër: Ndarja e 15% të fondeve kombëtare dhe të donatorëve për programet klimatike dhe të energjisë për projekte që u shërbejnë grave, të rinjve, pakicave etnike apo personave me aftësi të kufizuara. Të kërkojnë indikatorë të ndikimit gjithëpërfshirës në kriteret e financimit.
5. Krijimi i një kornize për qeverisje pjesëmarrëse: Institucionalizimi i kërkesave për konsultim publik për të gjitha strategjitë kombëtare dhe projektet e mëdha infrastrukturore me ndikim në mjedis. Krijimi i një portali kombëtar për pjesëmarrje për mbledhjen e komenteve dhe publikimin e rezultateve të konsultimeve.
6. Zhvillimi i fushatave të synuara për ndërgjegjësim: Lansimi i fushatave nëpër shumë platforma në shkolla, komunitete

29 Fondacioni i Shoqërisë Civile të Kosovës. Burimi: https://kcsfoundation.org/en/grants/?utm_source

30 Agjencia Austriake për Zhvillim. Burimi: <https://www.entwicklung.at/en/projects/detail-en/edi-plus-empowerment-of-kosovo-minorities-through-education-dialogue-and-involvement-in-decision-making-processes>

dhe media publike me fokus në të drejtat e amvisërive në fushën e energjisë, shëndetin mjedisor dhe reziliencën klimatike. Partneritet me organizatat e shoqërisë civile për ngritje të vetëdijes në komunitetet e marginalizuara.

7. *Monitorimi i përfshirjes në rezultatet e politikave: Të kërkohet që ministrinë e linjës të raportojnë çdo vit mbi përfshirjen e rezultateve të politikave, duke përdorur tregues sasiore siç janë numri i familjeve të prekura, shkalla e pjesëmarrjes sipas grupmoshës dhe përfshirja e qeverisjes vendore.*

4.6 Menaxhimi i mbeturinave

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë mbetet i parregulluar, i financuar dobët dhe jo i harmonizuar me kërkesat e Direktivës Kornizë të BE-së për Mbeturinat. Përderisa është shënuar progres në hartimin e legjislacionit – si miratimi i ligjeve për mbeturinat e ambalazhit dhe lëvizjen e mbeturinave të rrezikshme – zbatimi dhe mbikëqyrja mbesin të kufizuara. Infrastruktura për riciklim është minimale dhe shumica e komunave nuk kanë kapacitet apo stimuj për të zbatuar praktika të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave.

Korniza ekzistuese legjislative

Korniza ligjore përfshin Ligjin për Mbeturinat (2022), si dhe rregulloret shoqëruese për mbeturinat e ambalazhit dhe lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave. Ato paraqesin parimet e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit dhe konceptin “ndotësi paguan”. Edhe pse korniza ligjore formalisht vendos Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) dhe parimin “ndotësi paguan”, zbatimi është i paqëndrueshëm për shkak të kapaciteteve të kufizuara inspektuese dhe mungesës së mekanizmave të dedikuar të financimit. Shumë komuna nuk kanë burime financiare për të zbatuar ndarjen në burim apo për të krijuar infrastrukturë për riciklim, duke zbuluar një mospërputhje kritike ndërmjet detyrimeve ligjore dhe mundësive për zbatim. Këto sfida pasqyrojnë një problem më të gjerë sistematik: dështimin për të mbështetur

ambicien legjislative me mbështetje të qëndrueshme buxhetore. Strategjia e Integruar për Menaxhimin e Mbeturinave (2024–2035) dhe Plani i Veprimit (2024–2026) paraqesin një plan për përmirësimin e mbulueshmërisë së grumbullimit, infrastrukturës dhe shkallës së riciklimit. Megjithatë, strategjia nuk mbështetet nga një buxhet i dedikuar për zbatim dhe treguesit e saj të performancës nuk monitorohen aktualisht dhe as publikohen. Mungesa e përfshirjes, financimit dhe zbatimit ndikon ndjeshëm në funksionalitetin e sektorit. Për shembull, mungesa e proceseve gjithëpërfshirëse të planifikimit kufizon përfshirjen e komunitetit dhe llogaridhënien, ndërsa mungesa e alokimeve të mjaftueshme buxhetore pengon komunat në përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Infrastruktura dhe mbulueshmëria e shërbimeve

- *Riciklimi dhe ndarja: Shkalla e riciklimit në nivel vendi në Kosovë është rreth 2,5%, njëra ndër më të ulëtat në Evropë. Ndarja e mbeturinave në burim mungon pothuajse tërësisht dhe shumica e materialeve të riciklueshme përfundojnë në deponi zyrtare apo në deponi të paligjshme.*
- *Shërbimet e Mbledhjes: Zonat urbane kanë mbulueshmëri të mbledhjes së mbeturinave ndërmjet 90–95%, ndërsa zonat rurale mbesin të pambuluara. Nuk ekziston një regjistër i përgjithshëm i mbeturinave apo monitorim në kohë reale i frekuencës, rrugëve apo efikasitetit të mbledhjes.*
- *Hedhja e paligjshme e mbeturinave: Numri i deponive të paligjshme ka rënë nga 747 në vitin 2022 në 373 në vitin 2023, për shkak të fushatave të pastrimit dhe shtytjes për zbatim. Megjithatë, përsëritja e deponive të paligjshme mbetet e lartë për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe sanksioneve³¹.*
- *Burimet Njerëzore: Kosova ka më pak se 60 inspektorë mjedisorë që veprojnë në nivel kombëtar dhe komunal. Shumica e komunave nuk kanë të punësuar një zyrtar të përhershëm për menaxhimin e*

31 Komisioni Evropian. 2024. Burimi: Raporti për Kosovën, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

mbeturinave, duke u mbështetur në staf multifunksional pa trajnim teknik³².

Kufizimet strukturore

- **Financimi:** Komunat mbështeten në tarifa të kufizuara të shërbimeve dhe projekte ad hoc të donatorëve për të financuar operacionet e menaxhimit të mbeturinave. Kontributet e qeverisë qendrore janë minimale dhe nuk ekziston ndonjë mekanizëm i financimit të bazuar në performancë për të nxitur përmirësime në riciklim apo largim nga deponitë.
- **Monitorimi dhe raportimi:** Ndonëse është prezantuar një platformë digjitale me 20 tregues të performancës, ajo nuk përditësohet në mënyrë sistematike dhe nuk është e lidhur me masat e zbatimit. Të dhënat për gjenerimin, përbërjen dhe trajtimin e mbeturinave janë të fragmentuara dhe nuk janë të qasshme publikisht.
- **Sistemi i kompensimit për depozitimin (DRS):** Një sistem DRS për shishet e pijeve është në zhvillim, por ende nuk është pilotuar apo miratuar me ligj. Afati kohor për zbatimin e tij në të ardhmen mbetet i pacaktuar.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të modernizuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë dhe për të përmbushur parimet e ekonomisë qarkore të BE-së, rekomandohen masat në vijim:

1. **Detyrimi për ndarjen në burim të mbeturinave:** Ndryshimi i legjislacionit ekzistues për të kërkuar ndarjen e detyrueshme të materialeve të riciklueshme në nivel të amvisërive dhe bizneseve në të gjitha komunat deri në vitin 2026. Vendosija e sanksioneve për moszbatim dhe stimulj për zbatim të hershëm.
2. **Krijimi i një Portali kombëtar për të dhënat për mbeturina:** Funkcionalizimi i një platformë digjitale qendrore për monitorimin në kohë reale të mbledhjes, përpunimit dhe shkallës së deponimit

të mbeturinave. Të kërkohet dorëzimi i përmuajshëm i të dhënave nga komunat dhe operatorët privatë.

3. **Financimi i infrastrukturës përmes buxhetimit të gjelbër:** Krijimi i një linjë buxhetore kombëtare të dedikuar për infrastrukturën komunale të riciklimit dhe kompostimit. T'i jepet përparësi bashkëfinancimit me BE-në dhe donatorët bilateralë për ndërtimin e qendrave për rikuperimin e materialeve në rajonet që aktualisht varen nga deponitë.
4. **Zgjerimi i kapaciteteve të inspektimit dhe zbatimit:** Dyfishimi i numrit të inspektorëve të trajnuar për menaxhimin e mbeturinave deri në vitin 2026. Të caktohen inspektorë në nivel komunal në të gjitha qytetet me më shumë se 30.000 banorë.
5. **Funksionalizimi i Sistemit të Kompensimit për Depozitimin:** Miratimi i legjislacionit që mundëson një sistem kombëtar të kompensimit për depozitimin dhe të nisë një program pilot në dy komuna urbane deri në vitin 2025. Të përcaktohen rolet operative për prodhuesit, shitësit me pakicë dhe autoritetet komunale.
6. **Miratimi i një skeme të financimit komunal të bazuar në performancë:** Vendosija e granteve të kushtëzuara për komunat që dëshmojnë përmirësime në shkallën e riciklimit, mbulueshmërinë e mbledhjes apo zvogëlimin e deponive ilegale. Shpërndarja të bazohet në të dhëna të audituara të performancës.
7. **Përmirësimi i komunikimit publik dhe llogaridhënies:** Lansimi i tabelave vjetore të raportimit për mbeturinat për secilën komunë dhe të kërkohet nga autoritetet lokale publikimi i përmirësimeve të planifikuara, aktiviteteve të prokurimit dhe statistikave për trajtimin e ankesave.

4.7 Menaxhimi i ujit

Pavarësisht përpjekjeve të moderuara strategjike, sektori i menaxhimit të ujit në Kosovë vazhdon të jetë jofunksional dhe strukturisht i dobët. Strategjia e Rishikuar për Ujëra (2022–2030) përshkruan një vizion për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, megjithatë përparimi i prekshëm pengohet

32 Administrata e Tregtisë Ndërkombëtare e SHBA-së. 2024. Burimi: Udhëzuesi Komercial për Kosovën, <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/kosovo-waste-management-and-recycling>

nga mangësitë legislative, fragmentimi institucional dhe mungesa e investimeve. Vendi vazhdon të përballet me rritje të sfidave mjedisore dhe të shëndetit publik për shkak të ndotjes së pakontrolluar, mungesës së trajtimit të ujërave të zeza dhe kapaciteteve të ulëta administrative për zbatim.

Një mangësi e rëndësishme është varësia e vendit nga infrastruktura rudimentare. Në vitin 2024, vetëm në pesë komuna operojnë impiante funksionale për trajtimin e ujërave të zeza, e madje as këto nuk funksionojnë me kapacitet të plotë. Një shifër marramendëse prej 75% e ujërave të ndotura komunale shkarkohen të patrajtuara, shpesh drejtpërdrejt në trupat natyrorë ujorë. Në qytete si Ferizaj dhe Mitrovicë, sistemet e vjetruara të kanalizimit rrjedhin në lumenj, duke kontribuar në përkeqësimin e shëndetit të ekosistemeve dhe duke paraqitur rreziqe afatgjata për burimet e ujit të pijshëm.

Dimensioni institucional është po aq shqetësues. Inspektorët mjedisorë nuk kanë specializim në hidrologji dhe sisteme sanitare, me më pak se 10 inspektorë në gjithë Kosovën që kanë ekspertizë të drejtpërdrejtë në zbatimin e standardeve për cilësinë e ujit. Komunat, të cilat kanë role kyçe operative në mënyrë kronike ballafaqohen me nënfinancim dhe kryesisht janë të përjashtuara nga vendimmarrja, ndërsa sipas raportimeve vetëm 4% janë të përfshira në planifikimin e qeverisjes së ujit.

Për më tepër, ekziston një mungesë akute e të dhënave. Kosova ende nuk ka krijuar një platformë kombëtare për monitorimin e ujit. Indikatorët bazë si sasia ditore e ujit tërhequr, rastet e ndotjes apo përputhshmëria me standardet për shkarkimet industriale ose nuk mblidhen fare ose nuk janë të qasshme për publikun. Kjo mungesë e të dhënave pengon si reagimin ndaj krizave ashtu edhe planifikimin afatgjatë, duke krijuar një kulturë menaxhimi reaktive në vend të asaj proaktive.

Si shembull ilustrativ shërben pellgu i lumit Drini i Bardhë³³. Si burim kryesor i ujërave të ëmbla përballet me presione të shumta mjedisore: nxjerrje të paligjshme të zhavorrit, rrjedhje të lëndëve ushqyese nga tokat bujqësore dhe shkarkime nga industria e përpunimit të ushqimit. Megjithëse ekziston një draft plan për menaxhimin e pellgut lumor, ai ende nuk është miratuar dhe nuk janë pilotuar masa për zbatim.

Statusi ligjor dhe institucional

Megjithëse Ligji për Ujëra është në proces të rishikimit, i njëjti ende nuk është miratuar. Mungesa e legjislacionit të përditësuar pengon zbatimin e standardeve ekzistuese dhe vonon integrimin e parimeve të Direktivës Kornizë të BE-së për Ujërat. Për më tepër, planet për menaxhimin e pellgjeve lumore, të kërkuara si nga standardet kombëtare ashtu edhe ato të BE-së, mbetin në formë drafti dhe nuk zbatohen në planifikimin e infrastrukturës apo kontrollin e ndotjes.

Vetëm 4% të komunave janë të përfshira në mënyrë aktive në vendimmarrjen për menaxhimin e ujit. Strukturat lokale të qeverisjes së ujit – si këshillet e pellgjeve, njësitë e monitorimit apo zyrat e inspektimit – ose kanë burime të pamjaftueshme ose nuk janë të themeluara³⁴.

Infrastruktura dhe ndotja

- *Trajtimi i ujërave të zeza: Rreth 75% e ujërave të zeza komunale derdhen pa trajtim në lumenj dhe përrenj. Numri i kufizuar i impianteve funksionale për trajtimin e ujërave të zeza është i përqendruar në qendra urbane, ndërsa zonat rurale janë tërësisht të përjashtuara.*
- *Rezervuarët dhe furnizimi me ujë: Kosova ka kapacitet rezervimi prej 300 metra kub ujë për banor, shumë më pak se mesatarja rajonale prej 799 m³. Ky kapacitet i ulët e bën vendin të cënueshëm ndaj mungesave sezonale dhe kufizon produktivitetin bujqësor dhe industrial³⁵.*

33 Banka Botërore (2020): <https://www.worldbank.org/en/results/2020/10/27/developing-a-long-term-and-holistic-approach-to-strengthen-water-security-in-kosovo>

34 Komisioni Evropian. 2024. Burimi: Raporti për Kosovën, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

35 Banka Botërore. 2020. Burimi: Zhvillimi i një qasjeje afatgjatë dhe holistike për të forcuar sigurinë e ujit në Kosovë, <https://www.worldbank.org/>

- *Menaxhimi i ujërave nëntokësore: Rreth 26% e ujit të pijshëm në Kosovë vjen nga puse dhe shpime të thella, shumë prej të cilëve janë të parregulluar dhe të pamonitoruar. Lejet për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore nuk zbatohen në praktikë dhe nuk vlerësohen rreziqet e kontaminimit* ³⁶.
- *Monitorimi biologjik: Treguesit biologjikë të cilësisë së ujit – si makroinvertebrorët, algat apo popullatat e peshqve – nuk monitorohen në mënyrë sistematike. Vendi nuk ka një program kombëtar për biomonitorim, duke lënë të padokumentuara ndikimet e ndotjes në ekosisteme.*

Zbatimi dhe kapacitetet

Korniza institucionale karakterizohet nga koordinim i dobët ndërinstitucional dhe mungesë e theksuar e stafit:

- *Mungesa e inspektimeve:* Inspektimet mjedisore dhe të ujit kryhen nga një grup i vogël inspektorësh kombëtarë pa specializim në hidrologji apo sisteme sanitare. Shumë komuna nuk kanë asnjë inspektor me trajnim në menaxhimin e ujit.
- *Dobësitë në dhënien e lejeve:* Në procesin e lëshimit të lejeve për nxjerrjen e ujit dhe shkarkimin e ujërave të ndotura nuk ka konsistencë. Aplikimet shpesh përpunohen pa inspektime në terren apo vlerësime të ndikimit.
- *Disponueshmëria e të dhënave:* Konsumi i ujit, shkalla e humbjeve dhe rastet e ndotjes nuk regjistrohen në mënyrë sistematike. Nuk ekziston ndonjë portal i hapur për të dhënat mbi cilësinë e ujit, përdorimin apo përputhshmërinë me lejet.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të adresuar dështimet sistematike në menaxhimin e ujit dhe për të harmonizuar me standardet mjedisore të BE-së, Kosova duhet të ndër marrë reformat në vijim:

1. *Miratimi dhe zbatimi i një Ligji të ri për Ujërat:* Të finalizohet dhe miratohet Ligji i rishikuar për Ujërat deri në vitin 2025, duke përfshirë dispozitat e Direktivës Kornizë të BE-së për Ujërat. Të caktohen përgjegjësi të qarta për monitorimin, licencimin dhe

koordinimin e menaxhimit të pellgjeve lumore.

2. *Funksionalizimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve të lumenjve:* Të miratohen dhe zbatohen planet për menaxhimin e pellgjeve për të gjitha pellgjet kryesore deri në vitin 2026. Të krijohen këshille të pellgjeve me autoritet ligjor për të mbikëqyrur zbatimin lokal dhe për të koordinuar iniciativat ndërkomunale.
3. *Investimi në infrastrukturën për trajtimin e ujërave të zeza:* Të jepet përparësi ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në qytetet me mbi 15.000 banorë. Të alokohen fonde publike dhe financim nga donatorët për projektimin, operimin dhe monitorimin e performancës së impianteve.
4. *Krijimi i një kornize kombëtare për rregullimin e ujërave nëntokësore:* Të prezantohet regjistrimi dhe licencimi i detyrueshëm për të gjitha pikat e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore. Të kërkohet testimi i cilësisë së ujit dhe vlerësimi i ndikimit për pusët dhe burimet e reja.
5. *Zhvillimi i një programi për monitorimin biologjik:* Të lansohet një skemë kombëtare për biomonitorimin e ujërave deri në vitin 2026, me raportim vjetor mbi shëndetin e ekosistemeve ujore. Të krijohen partneritete me universitete dhe OJQ për mbledhjen e mostrave dhe interpretimin e të dhënave.
6. *Zgjerimi i kapaciteteve komunale dhe stafit teknik:* Të pajisen komunat me zyrtarë të dedikuar për ujërat, të trajnuar në licencim, monitorim dhe përputhshmëri. Të ofrohen grante të synuara për punësim në komunat me pika të nxehta të ndotjes së lumenjve.
7. *Krijimi i një platforme publike për të dhënat mbi ujin:* Të krijohet një platformë qendrore, e qasshme publikisht, për publikimin e të dhënave mbi përdorimin e ujit, rastet e ndotjes, lejet dhe performancën e infrastrukturës sipas komunës dhe pellgut lumor.

4.8 Sistemet e qëndrueshme ushqimore dhe zona rurale

Sistemet e qëndrueshme ushqimore në Kosovë mbeten më shumë aspiruese sesa funksionale, duke reflektuar një shkëputje midis qëllimit të politikave dhe realiteteve lokale. Sektori vazhdon të funksionojë nën një paradigmë konvencionale të përqendruar në produktivitet, me vëmendje të pamjaftueshme ndaj qëndrueshmërisë ekologjike, barazisë rurale dhe reziliencës së zinxhirit të vlerës. Edhe pse disa dokumente politike përmendin objektiva të gjelbra, përfshirë Planin Kombëtar të Veprimit për Bujqësinë Organike dhe Programin për Bujqësi Digjitale, ndikimi i tyre në terren është minimal.

Praktikat bujqësore në Kosovë në masë të madhe injorojnë cënueshmërinë nga klima dhe konsideratat për biodiversitetin. Për shembull, ndonëse Programi për Bujqësi Digjitale i mbështetur nga FAO propozon digjitalizimin e shërbimeve këshilluese bujqësore dhe monitorimin e tokës, ai ende nuk ka kaluar përtej studimeve të centralizuara të fizibilitetit. Shërbimet lokale këshilluese nuk janë të pajisura mirë për të vendosur ose mirëmbajtur mjetet digjitale, dhe shumica e fermerëve – veçanërisht ata në zonat malore dhe të populluara nga pakicat – mbeten të pavetëdijshëm për mekanizmat e mbështetjes në dispozicion.

Infrastruktura mbetet një pengesë thelbësore. Një pjesë e konsiderueshme e humbjeve ushqimore – e vlerësuar në 30% për produktet që prishën lehtë, lidhet drejtpërdrejt me logjistikën e dobët. Në Gjakovë dhe Dragash, kooperativat e mjedres dhe qumështit raportojnë prishje sezonale për shkak të mungesës së rrjeteve të magazinimit në frigorifer dhe transportit. Këto mangësi ulin të ardhurat e fermerëve dhe dekurajojnë diversifikimin drejt kulturave me vlerë më të lartë dhe më miqësore ndaj mjedisit³⁷.

Zhvillimi rural gjithashtu ka dështuar të përfshijë modele gjithëpërfshirëse të qeverisjes. Prodhuesit e vegjël, veçanërisht

gratë dhe pakicat etnike, rrallë konsultohen në hartimin e politikave apo përfshihen në skemat e prokurimit publik. Në kontrast me fqinjët rajonalë, Kosova nuk ka programe funksionale të tipit “nga ferma në shkollë” apo “prokurim ushqimor lokal” që lidhin prodhuesit me institucione publike si shkollat apo spitalet.

Statusi i politikave dhe kapaciteti institucional

Ekziston korniza e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural, përfshirë Planin Strategjik për Sistemin Këshillues të Kosovës dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Bujqësinë Organike 2023–2026, por vazhdon të jetë e shkëputur nga objektivat më të gjera të qëndrueshmërisë. Këto dokumente nuk përmbajnë objektiva të detyrueshme për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e biodiversitetit apo përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në praktikën bujqësore.

Programi për Bujqësi Digjitale, i zhvilluar me mbështetjen e FAO-s, paraqet një hap pozitiv drejt integritetit të të dhënave dhe teknologjisë në politikat bujqësore. Megjithatë, zbatimi mbetet i kufizuar në vlerësime të nivelit të lartë. Programi ende nuk përfshin mekanizma konkretë për trajnime, shërbime këshilluese apo përdorimin e mjeteve të mençura për klimën në nivel ferme³⁸.

Sfidat kryesore

- *Bujqësi e kufizuar organike dhe ekologjike:* Bujqësia organike e certifikuar përfaqëson më pak se 1% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor në Kosovë. Nuk ka subvencione kombëtare të lidhura posaçërisht me praktikat organike apo rigjeneruese, dhe skemat ekzistuese për mbështetje agromjedisore janë të fragmentuara apo të financuara dobët.
- *Dobësitë në infrastrukturë:* Shumë zona rurale përballen me qasje të dobët rrugore, sisteme të pasigurta të ujitjes dhe kapacitete të dobëta për ruajtje pas korresjes. Këto kufizime rrisin humbjet ushqimore, ulin konkurrueshmërinë dhe dekurajojnë investimet në praktika të qëndrueshme.

37 Komisioni Evropian. (2024). Raporti Vjetor për 2024. Bruksel.

38 FAO. 2024. Burimi: <https://www.fao.org/digital-villages-initiative/europe/news-and-articles/news-and-articles-detail/kosovo-launches-the-development-of-the-digital-agriculture-programme-and-action-plan-with-fao-support/en>

- *Mungesa e qasjes në treg:* Fermerët e vegjël nuk kanë qasje të qëndrueshme në tregjet vendore dhe ndërkombëtare për shkak të logjistikës së dobët të transportit, skemave të kufizuara të certifikimit dhe mungesës së iniciativave kolektive të marketingut.
- *Ekosistemi i pazhvilluar i inovacionit:* Institucionet kërimore bujqësore janë të financuara dobët dhe të integruara dobët në proceset politike kombëtare. Nuk ka thirrje kombëtare për kërkime të përqendruara në agroekologji, sekuestrimin e karbonit apo sisteme të kultivimit miqësore me biodiversitetin.
- *Neglizhim i grupeve të marginalizuara:* Gratë, të rinjtë dhe pakicat etnike mbesin kryesisht të përjashtuar nga organet vendimmarrëse në sektorin bujqësor. Ka pak programe të dizajnuara për të përmirësuar qasjen e tyre në tokë, kredi apo shërbime këshilluese.

Rezultat strategjike

- Varësia e Kosovës nga praktikat intensive bujqësore kontribuon në degradimin e tokës, humbjen e biodiversitetit dhe cenueshmërinë ndaj stresit klimatik. Pa ndërhyrje, bujqësia do të vazhdojë të performojë dobët si në aspektin e produktivitetit ashtu edhe në atë të qëndrueshmërisë.
- Vonesat në përafrimin e politikave kombëtare me standardet e zhvillimit rural të BE-së do të pengojnë qasjen e Kosovës në fondet e para-anëtarësimit për bujqësi dhe mekanizmat më të gjerë të mbështetjes për Agjendën e Gjellbër.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Kosova duhet të integrojë qëndrueshmërinë në agjendën e saj për bujqësi dhe zhvillim rural për të siguruar reziliencën e sistemit ushqimor, përputhshmërinë me klimën dhe konkurrueshmërinë afatgjatë. Rekomandohen masat si në vijim:

1. *Zhvillimi i një Strategjie kombëtare për bujqësi të gjellbër:* Të krijohet një strategji e unifikuar deri në vitin 2026 që përfshin objektiva për bujqësinë organike, shëndetin e tokës, biodiversitetin dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Të harmonizohet strategjia me objektivat

mjedisore të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP).

2. *Vendosja e subvencioneve për praktika të qëndrueshme:* Të dizajnohet një skemë e synuar pagesash agromjedisore që ofron stimuj financiarë të drejtpërdrejtë për alternim të të mbjellave, mbjellje mbuluese, zvogëlim të përdorimit të reduktuar të pesticideve dhe agropylltari. Të jepet përparësi mbështetjes për fermerët e vegjël dhe ata në zona të ndjeshme ndaj erozionit.
3. *Zgjerimi i infrastrukturës për qasje në treg:* Të investohet në rrugë rurale, objekte të magazinimit të ftohtë dhe njësi lokale të përpunimit përmes një fondi të dedikuar për infrastrukturën rurale. Financimi të lidhet me standarde të qëndrueshmërisë, si efikasiteti energjetik dhe reduktimi i mbeturinave.
4. *Zbatimi i Programit për bujqësi digjitale:* T'u ofrohet komunave dhe ndërmarrësive bujqësore pajisje, lidhshmëri dhe trajnim për të mbështetur sistemet digjitale të menaxhimit të fermave. Të krijohen parcela demonstrative rajonale që prezantojnë teknologji të reziliencës ndaj klimës.
5. *Promovimi i kërimit dhe inovacionit në bujqësinë e qëndrueshme:* Të financohet kërkimi i aplikuar në menaxhimin e karbonit në tokë, kontrollin organik të dëmtuesve dhe kulturat e përshtatura ndaj klimës. Të bashkëpunohet me universitetet për të lansuar grante konkurruese kërimore të lidhura me objektivat kombëtare të qëndrueshmërisë.
6. *Mbështetja e përfshirjes në zhvillimin rural:* Të përcaktohet që 30% e fondeve për zhvillim rural të alokohen për ndërmarrjet bujqësore në pronësi të grave, të rinjve dhe pakicave. Të futet buxheti i përgjegjshëm gjinor në të gjitha programet e financimit bujqësor.
7. *Monitorimi dhe raportimi mbi treguesit e qëndrueshmërisë:* Të kërkohet publikimi vjetor i indikatorëve agromjedisore, përfshirë përdorimin e plehrave, normat e aplikimit të pesticideve, efikasitetin e përdorimit të ujit dhe përqindjen e tokës organike në kultivim.

4.9 Bujqësia

Bujqësia në Kosovë mbetet paradoksale: ajo është një shtyllë e jetesës rurale dhe e sigurisë ushqimore kombëtare, por në të njëjtën kohë jo e integruar në mënyrë strukturore me imperativët e qëndrueshmërisë dhe objektivat e integritimit evropian. Kontributi i lartë i sektorit në Vlerën e Shtuar Bruto (7,8% në vitin 2023) maskon joefikasitetin e thellë, ndikimet mjedisore negative dhe konkurrueshmërinë e dobët³⁹.

Modeli aktual karakterizohet nga praktika shfrytëzimit të tepruar dhe mendësi afatshkurtër. Erozioni i tokës në zonat kodrinore si Anamorava dhe Dukagjini ka arritur nivele kritike, me një humbje të vlerësuar prej 5–10 tonë dheu sipërfaqësor për hektar në vit. Këto humbje, të kombinuara me varësinë në rritje nga plehrat e importuara – me një rritje prej 24% që nga viti 2019 – tregojnë për një sistem nën presion. Megjithatë, Kosova nuk ka një Program Kombëtar për Shëndetin e Tokës dhe nuk ekziston ndonjë ligj që rregullon konvertimin e tokës apo ndotjen e saj. Për më tepër, bilanci tregtar i Kosovës në produktet agro-ushqimore mbetet i theksuar: Eksportet e BE-së drejt Kosovës arritën në 598 milionë euro në vitin 2023, ndërsa importet nga Kosova ishin vetëm 48 milionë euro, duke theksuar mungesën e konkurrueshmërisë si në sasi ashtu edhe në cilësi⁴⁰.

Politikat e subvencioneve i thellojnë më tej praktikat e paqëndrueshme. Më shumë se 70% e pagesave bujqësore janë të bazuara në sipërfaqe, pa ndonjë lidhje me performancën mjedisore apo përshtatjen ndaj klimës. Kjo qasje favorizon prodhuesit më të mëdhenj dhe konvencionalë dhe ofron pak nxitje për bujqësi miqësore ndaj biodiversitetit, diversifikim të kulturave apo përdorim të reduktuar të pesticideve.

Në aspektin institucional, shërbimet këshilluese mbesin të fragmentuara dhe jo të financuara mjaftueshëm. Agjentët operojnë

pa trajnim të standardizuar dhe nuk ekziston ndonjë sistem vlerësimi të performancës. Ndërkohë, ekosistemi kërkimor është pothuajse i përjashtuar nga proceset politike. Nuk janë alokuar fonde publike për testime agroekologjike apo ferma demonstrative – një mjet thelbësor për përhapjen e inovacioneve të qëndrueshme.

Mungesa e Kosovës në programet e BE-së të financimit bujqësor para-anëtarësimit (si IPARD III) është simptomë e kësaj mospërputhjeje. Pa reforma që përfshijnë gjurmueshmërinë, garancitë mjedisore dhe strategjitë e integritimit në treg, sektori rrezikon margjinalizim në ekonominë agro-ushqimore evropiane në zhvillim.

Korniza politike dhe progresi institucional

Disa dokumente kyçe janë miratuar vitet e fundit, përfshirë Ligjin për Organizimin e Tregut për Produktet Bujqësore, Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (2023–2027) dhe Planin Strategjik për Sistemin Këshillues të Kosovës. Përderisa këto instrumente krijojnë një strukturë formale për qeverisjen e sektorit, ato nuk përfshijnë përshtatjen ndaj klimës, mbrojtjen e mjedisit apo ruajtjen e biodiversitetit si rezultate të matshme të politikave.

Plani Kombëtar i Veprimit për Bujqësinë Organike (2023–2026) përshkruan objektiva për promovimin e bujqësisë organike, por mungon një linjë e dedikuar financimi, afat kohor zbatimi apo kornizë institucionale llogaridhënëse.

Sfidat operative dhe mjedisore

- Shfrytëzimi i tokës dhe degradimi i tokës: Kosova nuk ka një kornizë rregullative të detyrueshme për shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës apo mbrojtjen e saj. Zgjerimi i zonave bujqësore shpesh ndodh pa vlerësim mjedisor, duke çuar në erozion, humbje të shtresës së dheut të sipërm dhe ndotje të rrjedhave ujore⁴¹.*

39 Të dhënat e Grupit të Bankës Botërore. 2023. Burimi: <https://data.worldbank.org/indicator/NV.AGR.TOTL.ZS?locations=XK&utm>

40 Bashkimi Evropian në Kosovë. 2024. Burimi: Buletini statistikor për tregti agro-ushqimore, https://agriculture.ec.europa.eu/system/files/2023-05/agrifood-kosovo_en.pdf

41 Komisioni Evropian. 2024. Burimi: Raporti për Kosovën, https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en

- *Shërbime këshillimore të fragmentuara:* Shërbimet këshillimore nuk janë të financuara sa duhet dhe të fragmentuara ndërmjet komunave dhe agjencive. Nuk ekziston ndonjë program trajnimi i standardizuar apo sistem kombëtar vlerësimi për agjentët këshillues.
- *Integrimi agro-mjedisor mungon:* Projektet agro-solare, integrimi i kulturave me blegtorinë dhe permakultura mbesin të pazhvilluara për shkak të mungesës së qartësisë rregullative dhe pilot-iniciativave. Nuk ekziston ndonjë regjistër kombëtar për pilot-projektet e bujqësisë së qëndrueshme apo feramat demonstrative.
- *Mungojnë treguesit agro-mjedisorë:* Kosova nuk i përcjellë të dhënat për përdorimin e plehrave për hektar, eficiencën e ujitjes apo emetimet bujqësore në sistemin e saj statistikor kombëtar, duke e bërë të pamundur vlerësimin e ndikimeve mjedisore apo hartimin e politikave korrigjuese.
- *Mbrojtja e tokës bujqësore:* Nuk ekziston ndonjë mekanizëm strategjik për mbrojtjen e tokës bujqësore nga konvertimi për përdorime jo-bujqësore. Zgjerimi urban dhe ndërtimet joformale vazhdojnë të zvogëlojnë bazën e tokës bujqësore në Kosovë⁴².

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të ndërtuar një sektor bujqësor modern, të qëndrueshëm dhe në pajtim me BE-në, Kosova duhet të integrojë qëndrueshmërinë mjedisore në modelin e saj të zhvillimit bujqësor. Rekomandohen veprimet si në vijim:

1. *Miratimi i masave legjislative për mbrojtjen e tokës dhe dheut:* Të miratohet Ligji për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore që vendos kufizime për konvertimin e tokës për përdorime jo-bujqësore dhe që parashikon sanksione për zhvillimet e paautorizuara. Të përfshihen tregues për erozionin dhe pëlleshmërinë e tokës në planifikimin e përdorimit të tokës.
2. *Funksionalizimi i integritetit agro-diellor:* Të zhvillohen udhëzime teknike dhe ligjore për sistemet me përdorim të dyfishtë të tokës që kombinojnë prodhimin e energjisë së ripërtëritshme me kultivimin e kulturave. Të lansohen projekte pilot në rajone me po-

tencial të lartë diellor dhe mbulim të ulët të ujitjes.

3. *Fuqizimi i sistemeve këshillimore dhe certifikimit:* Të standardizohet dhe zgjerohet shërbimi këshillues bujqësor me trajnime për praktika të qëndrueshme ndaj klimës, prodhim organik dhe integrim në treg. Të vendosen objektiva të performancës dhe mekanizma monitorimi për personelin këshillues.
4. *Përsheptimi i legjislacionit në pritje:* Të finalizohet dhe zbatohet legjislacioni zbatues për organizimin e tregut të produkteve bujqësore. Të futen kërkesa për gjurmueshmëri dhe etiketim për produktet vendase për të mbështetur qasjen në treg dhe besimin e konsumatorëve.
5. *Përshtatja e subvencioneve me rezultatet mjedisore:* Të kushtëzohet një pjesë e subvencioneve bujqësore me pajtueshmërinë me praktikën mjedisore, siç janë përdorimi i reduktuar i plehrave, sistemet e ujitjes që kursejnë ujë ose metodat e certifikuara organike.
6. *Krijimi i një Regjistri kombëtar për projektet e bujqësisë së qëndrueshme:* Të krijohet një platformë digjitale për të përcjellë të gjitha pilot-projektet, iniciativat kërkimore dhe programet e financimit që lidhen me bujqësinë e qëndrueshme. Të përdoret regjistri për qëllime monitorimi dhe replikimi.
7. *Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave agro-mjedisore:* Të ngarkohet Agjencia e Statistikave të Kosovës me përpilim të të dhënave vjetore mbi përdorimin e pesticideve dhe plehrave kimike, konsumin e energjisë në bujqësi dhe emetimet e GHG në bujqësi. Të integrohen këto të dhëna në raportimin e politikave bujqësore.

4.10 Biodiversiteti

Biodiversiteti në Kosovë vazhdon të jetë nën presion në rritje për shkak të degradimit të habitateve, zhvillimit të parregulluar dhe zbatimit të pamjaftueshëm të legjislacionit për ruajtjen e natyrës. Edhe pse vendi është zotuar ndaj disa kornizave ndërkombëtare – më e rëndësishmja Konventa e Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik (CBD) – zbatimi në nivel vendi mbetet i fragmentuar

dhe me resurse të kufizuara. Sipërfaqja e zonave të mbrojtura mbetet nën objektivat globale dhe të BE-së për biodiversitetin, ndërsa institucionet rregullative nuk kanë kapacitete financiare dhe teknike për të monitoruar dhe mbrojtur në mënyrë efektive habitatet natyrore.

Statusi dhe dobësitë në zonat e mbrojtura

Kosova ka përcaktuar 11,5% të territorit si zonë të mbrojtur, shumë më pak se objektivi i BE-së prej 30% deri në vitin 2030 dhe Objektivi i Biodiversitetit "Aichi" prej 17% për ekosistemet tokësore. Asnjë zonë nuk është aktualisht e shpallur si "e mbrojtur rreptësisht" sipas kategorive I apo II të IUCN. Për më tepër, shumica e zonave të mbrojtura nuk kanë plane të miratuara menaxhimi, staf të dedikuar apo infrastrukturë të përshtatshme për mbikëqyrje dhe mirëmbajtje.

- *Humbja e biodiversitetit vazhdon brenda zonave të mbrojtura e nxitur nga ndërtimet ilegale, zgjerimi i bujqësisë dhe turizmi i pakontrolluar.*
- *Hidrocentralet brenda parqeve kombëtare shpesh operojnë pa vlerësime gjithëpërfshirëse mjedisore, duke dëmtuar integritetin e habitateve dhe duke ndërprerë sistemet ujore.*

Kufizimet institucionale

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është autoriteti kryesor për monitorimin dhe politikat e biodiversitetit. Megjithatë, kapacitetin e ka tejte të kufizuar për shkak të mungesës së stafit, kufizimeve buxhetore dhe mungesës së pajisjeve shkencore dhe teknike.
- AMMK nuk mirëmban një bazë të dhënash në kohë reale për biodiversitetin e as nuk publikon vlerësime të rregullta për gjendjen e ekosistemeve apo të specieve.
- Koordinimi me komunat është i dobët. Qeveritë lokale nuk kanë mandat apo ekspertizë për të zhvilluar dhe zbatuar plane veprimi për biodiversitetin.

Mangësitë në monitorim dhe pajtueshmëri

- Monitorimi i specieve është sporadik dhe i kufizuar në projekte të financuara nga donatorët. Nuk ekziston një sistem

kombëtar për monitorimin e bollëkut të specieve, rrezikut të zhdukjes apo fragmentimit të habitateve.

- Menaxhimi i specieve invazive nuk është i integruar në strategjitë kombëtare të ruajtjes, pavarësisht rreziqeve në rritje për ekosistemet ujore dhe tokësore.
- Vlerësimet e ndikimit në mjedis (VNM) nuk përfshijnë indikator gjithëpërfshirës për biodiversitetin, ndërsa masat zbutëse rrallëherë monitorohen pas miratimit të projekteve.

Konteksti rajonal

Kosova mbetet prapa vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor në mbrojtjen e biodiversitetit. Për krahasim:

- Shqipëria mbron 18,6% të territorit të vet,
- Mali i Zi mbron 14%,
- Maqedonia e Veriut mbron 8,9%,
- Serbia mbron 7,7%, dhe
- Bosnja dhe Hercegovina mbron vetëm 3,6%⁴³.

Pozicioni i Kosovës është mesatar për sa i përket mbulimit, por mbetet prapa në zbatimin e ligjit, restaurimin e ekosistemit dhe pjesëmarrjen në platformat ndërkombëtare të ruajtjes.

Vlerësimi dhe Rekomandimet e BGF

Për të harmonizuar qeverisjen e biodiversitetit me standardet ndërkombëtare dhe për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjate të ekosistemeve, Kosova duhet të ndërmarrë masat në vijim:

1. *Zgjerimi dhe përmirësimi i zonave të mbrojtura:* Të rritet përqindja e territorit të vendit nën mbrojtje në të paktën 17% deri në vitin 2027, me synimin për të arritur 30% deri në vitin 2030. T'i jepet prioritet zonave me vlerë të lartë ekologjike dhe të përcaktohet një nëngrup si zonë e mbrojtur rreptësisht, në pajtim me kërkesat e Strategjisë së Biodiversitetit të BE-së.
2. *Detyrimi për hartimin e planeve lokale të veprimit për biodiversitetin:* Të kërkohet që komunat me zona të mbrojtura të zhvillojnë dhe zbatojnë Plane Vendore të Veprimit për Biodiversitetin (PVVB). Të ofrohet asistencë teknike dhe financim

43 Instituti Aspen. 2021. Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor: Rruga drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike.

përmes një fondi të dedikuar për biodiversitetin.

3. *Fuqizimi i Kapaciteteve të AMMK-së*: Të rritet buxheti vjetor dhe stafi i AMMK-së për të paktën 50% deri në vitin 2026. Të pajiset agjencia me mjete monitorimi të biodiversitetit, kapacitete për GIS dhe sisteme gjurmimi të specieve.
4. *Hartimi i një sistemi kombëtar për monitorimin e biodiversitetit*: Të krijohet një baze e centralizuar e të dhënave për të ndjekur indikatorët kryesorë si trendët e popullatave të specieve, gjendjen e habitateve dhe rezultatet e konservimit. Të publikohen raporte vjetore për gjendjen e biodiversitetit, të cilat do të jenë të qasshme për politikëbërësit dhe publikun.
5. *Rregullimi i projekteve hidroenergjetike në zonat e mbrojtura*: Të ndalohen projektet e reja të hidrocentraleve brenda zonave të mbrojtura, përveç nëse kryhen vlerësime të plota strategjike mjedisore. Të kërkohen plane rikonstruksioni dhe auditime përputhshmërie për objektet ekzistuese.
6. *Integrimi i biodiversitetit në VNM dhe planifikimin e përdorimit të tokës*: Të rishikohen udhëzimet për VNM për të përfshirë indikatorë të standardizuar të biodiversitetit dhe vlerësime të ndikimit afatgjatë në habitate. Të kërkohet monitorim dhe raportim pas ndërtimit si kusht për miratimin e projekteve.
7. *Promovimi i projekteve të restaurimit të ekosistemit*: Të lansohen nisma për pyllëzim, restaurim të ligatinave dhe lidhje të habitateve në zonat e degraduara. Të harmonizohen projektet me prioritetet e Marrëveshjes së Gjellbër të BE-së dhe të kërkohet bashkëfinancim përmes fondeve ndërkombëtare të biodiversitetit.

Pavarësisht miratimit të një sërë strategjish dhe ligjesh themelore – përfshirë Strategjinë e Energjisë 2022–2031, Ligjin për Ndryshimet Klimatike dhe PKEK të ardhshëm – zbatimi mbetet tepër i ngadalshëm dhe i fragmentuar për të përmbushur ambiciet e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor apo standardet e integritit në BE.

Hendeku ndërmjet zotimeve politike dhe rezultateve konkrete nuk duhet të tolerohet më. Agjenda e Kosovës për qëndrueshmëri rrezikon të ngecë pa një shtytje të përqendruar dhe të përgjegjshme për zbatim. Kjo nuk është vetëm një sfidë teknike – është imperativ qeverisës dhe i drejtësisë sociale.

Mangësitë në zbatim, kapacitetet e pamjaftueshme institucionale dhe koordinimi i dobët ndërministror vazhdojnë të pengojnë progresin në të gjitha sektorët. Liberalizimi i tregut të energjisë mbetet i papërfunduar, ndërsa projektet për energji të ripërtëritshme përballen me vonesa për shkak të pasigurisë rregullative dhe kapaciteteve të pamjaftueshme operative. Politikat klimatike ekzistojnë, por zbatimi i tyre është i dobët, me burime të kufizuara dhe linja të paqarta përgjegjësie ndërmjet institucioneve. PKEK duhet të miratohet dhe të përdoret si nxitës për reforma sistematike, e jo si një ushtrim burokratik.

Drejhtësia mjedisore vazhdon të mos adresohet sa duhet. Përfshirja dhe barazia janë ende në periferi të politikëbërjes së gjelbër. Kosova nuk ka një përkufizim ligjor për varfërinë energjetike, duke lënë mijëra amvisëri të cënueshme të padukshme në të dhëna dhe të përjashtuara nga skemat mbështetëse. Pavarësisht fondeve ekzistuese dhe pilot-projekteve, komunitetet e marginalizuara – banorët ruralë, gratë, pakicat etnike – rrallëherë përfshihen në mënyrë domethënëse në planifikimin klimatik apo përfitojnë nga investimet e gjelbra. Kjo bie ndesh me frymën dhe përmbajtjen e parimit të BE-së për “të mos e lënë askënd prapa”.

Reformat në menaxhimin e mbeturinave dhe ujërave kanë filluar, por pa fuqizimin teknik dhe financiar të komunave, edhe strategjitë më të avancuara do të dështojnë. Njëjtë, edhe pse bujqësia kontribuon ndjeshëm në BPV

dhe punësim, ajo vazhdon të mbështetet në praktika të vjetruara dhe të paqëndrueshme. Ky sektor ka nevojë për një drejtim të qartë politik për t’u përafruar me qëndrueshmërinë klimatike, mbrojtjen e biodiversitetit dhe standardet e tregut të BE-së.


Prioritetet politike për veprim

Për të mbyllur hendekun gjithnjë e më të madh të zbatimit dhe për të siguruar një tranzicion të drejtë dhe gjithëpërfshirës, politikëbërësit në Kosovë duhet të veprojnë me vendosmëri në këto drejtime:

Veprimi	Institucioni drejtues
1. Miratimi dhe vënia e menjëhershme në funksionim e PKEK , me përgjegjësi të qarta, afate dhe rishikime vjetore të progresit.	Ministria e Ekonomisë
2. Institucionalizimi i zbatimit të ligjit duke rritur përmes rritjes së ndjeshme të stafit dhe kapaciteteve në agjencitë kyçe, veçanërisht për inspektimin mjedisor, monitorimin klimatik dhe qeverisjen e energjisë.	Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
3. Përkufizim ligjor dhe monitorim i varfërisë energjetike përmes Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe zhvillim i skemave mbështetëse të synuara për amvisëritë e cenueshme brenda kornizës së PKEK-së.	Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës
4. Integrim thelbësor në të gjitha fondet për klimë dhe energji, duke ndarë përqindje të dedikuara për gratë, të rinjtë, pakicat dhe personat me aftësi të kufizuara.	Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
5. Fuqizimi i komunave me financim të drejtpërdrejtë, mbështetje teknike dhe mandate për përfshirje, për të zbatuar në mënyrë efektive iniciativat lokale të gjelbra.	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
6. Zhvillimi i një udhërrëfyese për financimin e gjelbër , duke integruar qëndrueshmërinë në buxhetim publik dhe duke siguruar përgjegjësi klimatike në të gjitha investimet kapitale në të ardhmen	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
7. Forcimi i qeverisjes ndërsektoriale përmes krijimit të trupave koordinues në nivel të lartë me mandat për të mbikëqyrur zbatimin e Agjendës së Gjelbër në të gjitha ministrinë.	Zyra e Kryeministrit

Këto veprime të rekomanduara do të forcojnë themelin e politikave tona, do të ndërtojnë kapacitete njerëzore për zbatim dhe do të sigurojnë që rruga jonë drejt tranzicionit të jetë gjithëpërfshirëse. Tranzicioni i gjelbër i Kosovës nuk do të ketë sukses vetëm përmes deklaratave politike. Kërkon një riorganizim të qëllimshëm të prioritetëve, institucioneve dhe investimeve – të mbështetura në përfshirje, qëndrueshmëri dhe reformë të qeverisjes afatgjatë. Përmes iniciativave për

bashkëpunim, siç janë forumet e dialogut dhe rishikimet e politikave, të gjithë palët e interesuara mund të sigurohen që të shprehin mendimet e tyre. Agjenda e Gjelbër vetëm kështu mund të nxisë transformimin strukturor në përputhje me zotimet e BE-së dhe rajonit. Një Agjendë e Gjelbër e suksesshme duhet të ofrojë jo vetëm zvogëlim të emetimeve, por edhe barazi, reziliencë dhe të drejtën e çdo qytetari për një të ardhme të pastër dhe të qëndrueshme.



1. Banka Evropiane e Investimeve. "Ekipi i Evropës: Mbështetja globale e EIB për modernizimin e rrjetit hekurudhor në Kosovë arrin në 80 milionë euro". Banka Evropiane e Investimeve, 20 shkurt 2023. <https://www.eib.org/en/press/all/2023-051-team-europe-eib-global-support-for-railway-network-modernisation-in-kosovo-reaches-eur80-million>.
2. Koha.net. "Ekspertët e Mjedisit Kritikojnë Institucionet për Mospërforcim të Sistemit për Riciklimin e Mbeturinave." Koha.net, 2025. <https://www.koha.net/en/arberi/ekspertet-e-mjedisit-kritikojne-institucionet-per-moskonsolidim-te-sistemit-per-riciklim-te-mbeturinave>.
3. Swisscontact. Përmirësimi i Sistemeve të Tregut Bujqësor në Kosovë: Vështrime nga një studim i ri. 2025. <https://www.swisscontact.org/en/news/enhancing-agricultural-market-systems-in-kosovo-insights-from-a-new-study>.
4. Balkan Energy News. "Kosova miraton ligjin e parë mbi ndryshimet klimatike." Balkan Green Energy News, 12 janar 2024. <https://balkangreenenergynews.com/kosovo-adopts-first-law-on-climate-change/>.
5. Deutsche Energie-Agentur (DENA). Sfidat dhe mundësitë e Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit të BE-së (CBAM) për vendet e Ballkanit Perëndimor. Berlin: DENA, n.d. https://www.berlinprocess.de/uploads/documents/factsheet-challenges-and-opportunities-of-the-eu-carbon-border-adjustment-mechanism-cbam_1729075153.pdf.
6. German Economic Team (GET). CBAM dhe Kosova: Implikimet Ekonomike dhe Përjashtimet Potenciale për Eksportet e Energjisë Elektrike në BE. 2024. <https://www.german-economic-team.com/en/publication/policy-briefing-cbam-and-kosovo-economic-implications-and-potential-exemption-for-electricity-exports-to-eu/>.
7. Raporti i Progresit për vitin 2024 të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2022-2025. Burimi: <https://me.rks-gov.net/en/energy-2/>
8. Drejtor i Departamentit të Energjisë, Ministria e Ekonomisë. Intervistë nga Sytrime Dervisholli. Prishtina, 2025.
9. Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti Vjetor 2024. Prishtina: Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2024.
10. Joint Research Center. Tranzicioni i Gjellbër dhe Specializimi i Mençur në Ballkanin Perëndimor. 2024.
11. Eurostat. Statistikat e Shpjeguara. 2024. <https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?oldid=641466&utm>.
12. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bilanci i Energjisë në Kosovë 2023. 2024. <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8481..>
13. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Bilanci i Energjisë në Kosovë 2023. Prishtina: Agjencia Statistikore e Kosovës, 2024. <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8481>.
14. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
15. Joint Research Center. Tranzicioni i Gjellbër dhe Specializimi i Mençur në Ballkanin Perëndimor. Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2024.
16. Zyra e Planifikimit Strategjik, Zyra e Kryeministrit. Intervistë nga Sytrime Dervisholli. Prishtina, 2025.
17. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Artikull Lajmesh. 2025. <https://mmphi.rks-gov.net/News/NewsArticle?ArticleID=2464>.
18. Drejtori Ekzekutiv i OJQ-së "EcoZ." Intervistë nga Sytrime Dervisholli. Prishtina, 2025.
19. Po aty.
20. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Përmbledhje e Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit. 2025. <https://mmphi.rks-gov.net/Others/Department?DepartmentID=5>.
21. Reuters. "Dashuria e Re e Ballkanit për Kondicionerët e Ajrit e Tendos Rrjetin Teksa Temperaturat Rriten." Reuters, 14 Gusht 2024. <https://www.reuters.com/world/europe/balkans-new-love-air-conditioning-strains-grid-temperatures-soar-2024-08-14/>.
22. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë. Të Dhëna dhe Statistika. 2022. <https://www.iea.org/data-and-statistics>.
23. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. <https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo->

-
- report-2024_en.
24. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). "BERZH forcon mbështetjen për institucionet qeveritare të Kosovës." BERZH, 2025. <https://www.ebrd.com/home/news-and-events/news/2024/ebrd-strengthens-support-to-kosovos-governmental-institutions.html>.
25. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
26. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
27. Balkan Green Foundation. Raporti Kombëtar mbi Lidhjen midis Varfërisë Energjetike, Tranzicionit Energjetik dhe Komuniteteve të Energjisë në Zonat Rurale dhe Rolit të Rinjve në Kosovë. 2025.
28. Banka Botërore. Analiza e Varfërisë dhe Shpërndarjes së Varfërisë së Energjisë Elektrike dhe Mbrojtja e Konsumatorëve të Cenueshëm në Kosovë. Uashington, DC: Banka Botërore, 2019..
29. Fondacioni i Shoqërisë Civile të Kosovës. Përmbledhje e Granteve. Qasur në vitin 2025. https://kcsfoundation.org/en/grants/?utm_source.
30. Agjencia Austriake për Zhvillim. EDI Plus – Fuqizimi i Minoriteteve të Kosovës përmes Arsimit, Dialogut dhe Përfshirjes në Proceset e Vendimmarrjes. Qasur në vitin 2025. <https://www.entwicklung.at/en/projects/detail-en/edi-plus-empowerment-of-kosovo-minorities-through-education-dialogue-and-involvement-in-decision-making-processes>.
31. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
32. Administrata Amerikane e Tregtisë Ndërkombëtare. Kosova – Udhëzuesi Tregtar i Vendit: Menaxhimi dhe Riciklimi i Mbeturinave. 2024. <https://www.trade.gov/country-commercial-guides/kosovo-waste-management-and-recycling>.
33. Banka Botërore. Zhvillimi i një qasje afatgjatë dhe holistike për të forcuar sigurinë e ujit në Kosovë. 2020. <https://www.worldbank.org/en/results/2020/10/27/developing-a-long-term-and-holistic-approach-to-strengthen-water-security-in-kosovo>.
34. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
35. Banka Botërore. Zhvillimi i një qasje afatgjatë dhe holistike për të forcuar sigurinë e ujit në Kosovë. 2020. <https://www.worldbank.org/en/results/2020/10/27/developing-a-long-term-and-holistic-approach-to-strengthen-water-security-in-kosovo>.
36. Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së "EcoZ". Intervistë nga Sytrime Dervisholli. Prishtina, 2025..
37. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
38. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO). "Kosova nis zhvillimin e Programit dhe Planit të Veprimit të Bujqësisë Dixhitale me mbështetjen e FAO-s." 2024. <https://www.fao.org/digital-villages-initiative/europe/news-and-articles/news-and-articles-detail/kosovo-launches-the-development-of-the-digital-agriculture-programme-and-action-plan-with-fao-support/en>.
39. Grupi i Bankës Botërore. Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi, Vlera e Shtuar (% e PBB-së) – Kosova. 2023. <https://data.worldbank.org/indicator/NV.AGR.TOTL.ZS?locations=XK&utm>.
40. Bashkimi Evropian në Kosovë. Fletëpalosje Statistikore e Tregtisë Agro-Ushqimore: Kosova. 2024. https://agriculture.ec.europa.eu/system/files/2023-05/agrifood-kosovo_en.pdf.
41. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
42. Komisioni Evropian. Raporti për Kosovën 2024. Bruksel: Komisioni Evropian, 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en.
43. Instituti Aspen. Axhenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor: Rruga drejt Rritjes së Qëndrueshme Ekonomike. 2021.

